

VALERIA TONINI
NJË DASHURI NË LISTËPRITJE
ROMAN

BOTIMET TOENA

VALERIA TONINI

NJË DASHURI NË LISTËPRITJE

ROMAN

Përktheu nga italishtja: Sonila Kapo

BOTIMET TOENA

Titulli original: Un amore in lista d'attesa
Botoi në original: Edizioni Pendragon, 2023

“Quest’opera è stata tradotta con il contributo del Centro per il libro e la lettura del Ministero della Cultura italiano.”

“Përkthimi i kësaj vepre është realizuar me kontributin e Qendrës për librin dhe leximin të Ministrisë së Kulturës italiane.”



Botuese: Irena Toçi

Redaktore shkencore: Dr. Ina Arizaj
Korrektore letrare: Sonila Kryeziu
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN: 9789928960078

© Edizioni Pendragon, ITALY
© AUTORI dhe BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. “M. Gjollësja”, nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

*Për gjithë familjen time,
për pacientët e mi,
për gjithë ata që i dua shumë.*

Ka një vijë ndarëse midis tokës ku jetojmë dhe asaj të dëshirave tona. Dhe ne, në ato pak ditë, ishim të lumtur mbi këtë vijë ndarëse. Të lumtur, pavarësisht të gjithave. Të lumtur që mund të qëndronim aty pa bërë zgjedhje. Të varur mes së shkuarës dhe së ardhmes, mes jetës sonë dhe asaj të ëndrrave tona.

Me iluzionin se mund t'i kishim të dyja.

Kapitulli 1

Nëntë gramë hemoglobinë

Gjithçka filloi në një pasdite mbyttëse shtatori. Sapo isha ulur në një bar mbi lumin Senë, kur më mori në telefon Rëneja.

- Doktoreshë, më vjen keq që po ju shqetësoj. E di që sapo dolët nga spitali, por kanë nevojë për ju tek Urgjenca.

- Por, tani sapo dola. Më thuaj... - Nuk i lashë kohë të përgjigjej, e mbërthyer tashmë nga vorbulla e anktheve të mia të organizimit.

- Nëse mendon që duhet operuar, transferoje menjëherë në repart dhe fillo përgatitjet në sallën e operimit.

- Jo, nuk ju telefonova për këtë. Për momentin nuk ka asnjë pacient për ndërhyrje kirurgjikale. Ju mora më shumë për njëfarë shqetësimi.

- Për çfarë shqetësimi bëhet fjalë?

- Është shtruar një tip mjaft i famshëm, një shkrimtar.

- Dhe pastaj?

- Asgjë me rëndësi. Është i shoqëruar nga një mik i tij, sepse kishte humbur ndjenjat. Më shumë se një humbje ndjenjash ka qenë një ndjesi të fikëti. Ka një dhembje në anën e djathtë, por barku është i butë. Nuk ka leukocitozë dhe as rritje të PCR-së. Vërehet vetëm një anemi. Hemoglobinën e ka 9. Për mendimin tim, do të thosha se nuk ka asgjë urgjente.

- Dhembje në anën e djathtë dhe anemi. I duhet bërë një kolonoskopi.

- E kuptova se për çfarë po mendoni. Edhe unë të njëjtën gjë mendova. Thotë se, herë pas here, ka vënë re feçe të errëta. Unë, gjithsesi, do t'i bëja edhe një TAC.

- Shumë mirë.

- Problemi është se kemi të paktën katër pacientë të tjerë, të cilët kanë më urgjencë sesa ai. Dy prej tyre kanë pësuar trauma në aksident. Njëri prej tyre, për mua, nuk ka asgjë, për të dytin nuk e di akoma. Gjithsesi, shkrimtari përbën problem.

- Nuk po e kuptoj. Shpjegoi se nuk ka asgjë urgjente dhe se duhet të presë pak për arsye që nuk varen nga ne. Pastaj, nëse gjithçka shkon mirë, thuaji të vijë nesër në ambulancë që t'i programojmë një endoskopi.

- Nuk është dhe aq e lehtë. Pacienti është i shoqëruar nga një gazetar i *Le Monde*-it. Njëfarë Rimbo. Një grindavec i paparë. Thotë që është një shkrimtar i madh dhe se është ftuar në Paris për prezantimin... me sa kuptova të një romani. Duhet të bëjnë një sërë takimesh të rëndësishme... dhe bla-bla-bla. Shkurt, është një nga ata që s'dinë të pushojnë.

- Po përse duhet të shqetësohemi ne për takimet e tyre?

- Eh, na takon të shqetësohemi paksa. Tha se nuk mund të humbasin kaq kohë në Urgjencë. Dhe nëse nuk nxitojmë do t'i thotë drejtorit të gazetës që të marrë në telefon drejtorin e përgjithshëm të spitalit. Pastaj do ta shikojmë, më tha.

- Do të shikojmë, çfarë? Nëse ka pacientë që kanë probleme më urgjente se ai nuk është faji i askujt. Megjithatë, nëse nuk duan të humbin më shumë kohë, le të ikin. Madje thuaju që fole edhe me mua dhe se unë nuk dua t'ia di për rekomandimet e tyre. - Tonit të zërit ku ndihej njëfarë bezdie, i shtova edhe një të qeshur sfiduese.

- Nuk e di nëse do t'i telefonojnë vërtet drejtorit të përgjithshëm.

- As që dua t'ia di. Për mua të gjithë pacientët janë të barabartë. Madje, parapëlqej ata që nuk kanë rekomandime. Të tjerët nuk e kanë problem të gjejnë dikë që të kujdeset për ta.

- Më falni që po ju bezdis, por do të ishte mirë të vinit vetë këtu për ta zgjidhur këtë problem, - vazhdoi Rëneja me një ton lutës.

- Mirë, mos u shqetëso, po vij menjëherë, - u përgjigja duke

u ngritur menjëherë nga tavolina. Në atë çast dielli po perëndonte pas kullës *Eiffel* dhe qielli ishte veshur me mijëra ngjyra, sikur dikush të kishte shtypur disa tubete gjigante dhe ngjyrat e dala prej tyre ishin përzierë duke formuar nuanca të pafund. Ishte vërtet mëkat t'i braktisja gjithë ato ngjyra, për t'u zhytur sërish në atë botën bardhezi nga e cila sapo kisha dalë.

- Më the që është një shkrimtar i famshëm? Si quhet? - pyeta para se ta mbyllja telefonatën.

- Zhan-Lui Moro.

Ndalova në vend dhe mora frymë thellë. Pata ndjesinë sikur po më mungonte ajri.

- Zhan-Lui Moro? - pyeta, duke u munduar të mos lija të kuptoj që përgjigjja ishte shumë e rëndësishme për mua. Ndoshta bëhej fjalë për ndonjë emnak ose, ndoshta, ishte vërtet ai. Nuk e di. Ndoshta edhe të dyja gjërat bashkë.

- Po, Zhan-Lui Moro, lindur më 3 shkurt 1978. Kështu është shkruar në fletën e pranimit.

- Largoje gazetarin para se të mbërrij unë, - thashë pas një pauze të gjatë. - Dua të shmang zënkat. Zhan-Lui Moro është francez dhe nuk ka nevojë për përkthyes.

- Po, e pashë që ka lindur në Paris. Por jeton në Nju-Jork.

- Po e di.

- E njihni?

- Po, e njoh.

Kapitulli 2

Trupat

Në Urgjencën e spitalit *Sacré Coeur*, njerëzit, edhe ata të famshmit, kthehen në trupa. Thjesht trupa që, për një arsye çfarëdo, kanë reshtur së funksionuari dhe presin me ankth dikë, që të jetë i aftë t'i riparojë. Në të dyja anët e pareteve të sallës së madhe, zgjatet një rresht i pafund shtretërisht me disa metra distancë nga njëri-tjetri, dhe të ndarë mes tyre nga perde të lehta, për t'iu lejuar trupave njëfarë intimiteti. Këtu, jeta e njërit ndërthuret me jetën e të tjerëve, trupi i njërit me atë të të tjerëve, madje edhe urina, jashtëqitjet e tyre, gjaku, të vjellat, djersa. Trupa, thjesht trupa, që kanë humbur dinjitetin e tyre E kam pyetur shpesh veten sesi arrijnë njerëzit ta pranojnë këtë përzierje. Por ndoshta përgjigjja është shumë më e thjeshtë sesa mendojmë. Kur sëmuren, njerëzit kanë nevojë për të tjerët. Kanë nevojë t'i ndiejnë afër. Kur vijnë këtu, nuk kanë çfarë të fshehin më. Urrejtjet, mlllefet, mosmarrëveshjet, zhduken. Mbetet vetëm frika, dhe është pikërisht frika, e cila i bën më në fund të ndiejnë afekSION.

Atë pasdite ishte radha e shkrimtarit të famshëm Zhan-Lui Moro që të dilte nga faqet e famshme të romanit të tij, për t'u kthyer thjesht në një trup si shumë të tjerë. Një trup, i cili kishte nevojë për dikë që ta riparonte. Dhe atë ditë, krejt rastësisht, ai dikush isha unë.

“Nuk qenka plakur aspak”, mendova sapo e pashë. Xhinse, këmishë të bardhë, syze *Ray-Ban* mbi ballë, njësoj si atëherë. Nuk

kishte pamjen e një të sëmuri, por as edhe të një shkrimtari të njohur. Nuk ishte i famshmi Zhan-Lui Moro, për të cilin flisnin të gjithë. Ishte Xhoi, i njëjti si shumë vite më parë. Ishte njësoj sikur koha të mos kishte kaluar fare.

- Ti? Por, a nuk punoje në spitalin *Cochin*?
- Kanë kaluar shumë vjet nga hera e fundit që jemi parë.
- Shtatë apo tetë vjet.
- Nuk i kam numëruar.
- Unë po.

Ishte i emocionuar. Edhe unë po aq sa ai, por u mundova që ai të mos e kuptonte, edhe pse nuk ishte diçka e lehtë.

- Çfarë bën në Paris? - e pyeta duke u munduar të dukesh a e shpenguar.

- Kam ardhur për të prezantuar romanin tim të fundit.

- Ah, nuk e dija. I kam lexuar të gjitha. Më kanë pëlqyer shumë, - u përgjigja pa e ngritur shikimin nga fleta e analizave laboratorike, që Rëneja ma kishte lënë në fund të shtratit.

- Më vjen mirë. Vërtet të kanë pëlqyer?

- Po, shumë, - u përgjigja me një ton të sjellshëm, por të ftohtë. - Më thuaj, përse je këtu?

- Isha në kafenenë aty jashtë me një gazetar. Befas, pata ndjesinë sikur po më binte të fikët. Ishte vetëm një çast. Por, Rimboja thirri një taksi dhe më shoqëroi këtu. Do të parapëlqejë të të takoja në një tjetër rrethanë...

- Nga pamja e jashtme do të thosha se nuk është diçka e rëndësishme, - u përgjigja duke e hedhur shpejt vështrimin mbi fletët e analizave.

- Përse nuk u përgjigje asnjëherë? Përse nuk doje të më takoje sërish? - pyeti me zë të ulët.

- Ti e di përse.

- Mund të takoheshim të paktën... Përse ta mbyllnim në atë mënyrë absurde...

- Nuk ishte e mundur, ti e di... Gjithsesi, tani jemi këtu për të folur për shqetësimet e tua, - iu përgjigja në mënyrë të prerë.

- Po, ke të drejtë. - Sistemoi dy herë syzet *Ray-Ban* mbi ballë, pastaj i hoqi dhe i vendosi mbi jastëk. Ndërsa unë u kujdesa të mbyllja mirë perdet që e ndanin me pacientin në krah. Një pauzë e shkurtër dhe disa rituale të shpejta për të larguar disa mendime, të cilat rrezikonin të grafallonin ashtu si uji i makaronave kur zjarri është shumë i fortë.

- Ke pasur shqetësime të tjera përveç atyre sot? - pyeta duke u përpjekur të gjeja të njëjtin ton të kujdesshëm që kam edhe me pacientët e tjerë.

- Siç i thashë edhe specializantes sate, ka disa kohë që ndihem gjithmonë i lodhur. Nganjëherë ndiej edhe një dhembje këtu në të djathtë.

- Të ta shikoj pak barkun.

Pata një ndjesi të çuditshme, ndërkohë që Xhoi zbërtheu kopsat e këmishës dhe uli zinxhirin e pantallonave për të më treguar barkun. Ishte e mundimshme të fshihja emocionin që ndjeva ndërsa zhytja dorën në lëkurën e tij. Çdo ditë shikoja pacientë të zhveshur lakuriq, prekja pacientë lakuriq, pa e pasur mendjen të lakuriqësia e tyre. Ndërsa me Xhoin, edhe ky kontakt i thjeshtë fizik merrte, për arsye krejtësisht të ndryshme nga ato çka kishim pasur në të shkuarën, një konotacion erotik që e kontrolloja me vështirësi.

- Po, pikërisht aty ku je duke prekur tani, ndiej dhembje herë pas here. Nuk është tamam dhembje. Është një ndjesi e bezdisshme, si rëndesë. Tani më duket sikur nuk e ndiej më.

- Nga frika zhduken të gjitha dhembjet, - komentova me shaka. - Nuk ke asgjë urgjente. E vetmja e dhënë që ka dalë nga analizat është anemia.

- Që do të thotë?

- Rënie e hemoglobinës. Rruazave të kuqe. Për këtë arsye të ra të fikët.

- Zgjati vetëm një çast. Por nga çfarë është shkaktuar? Mos është apendicit?

- Jo, apendicitin do ta përjashtoja me siguri.

- Eh, kjo më qetëson disi. Pata frikë se mos më shkaktonte ndonjë peritonit.

- Po të kishe peritonit nuk do të ishim këtu tani duke biseduar qetësisht. Je frikacak i madh. - I shoqërova fjalët me një të qeshur kumbuese.

- Jam më shumë se aq. Jam i terrorizuar. Pastaj, gjatë këtyre ditëve, kam një mal me takime dhe nuk do të kem as...

- Për fat të keq, nëse do të kesh nevojë duhet ta gjesh kohën. Megjithatë, të thashë që nuk ke apendicit, por jo se nuk ke asgjë. E ke hemoglobinën nëntë.

- Dhe sa duhet të jetë?

- Trembëdhjetë, katërbëdhjetë.

- Djall o punë! Cili mund të jetë shkak?

- Është një anemi sideropenike¹, që me siguri është krijuar në kohë. Për këtë arsye nuk të ka dhënë shqetësime të veçanta. Shkaqet mund të jenë të shumta. Duhet të bësh analiza. Je dobësuar?

- Nuk po të pyes së çfarë do të thotë anemi sideropenike, sepse edhe vetëm fjala më rrëqeth. Jo, nuk jam dobësuar. Specializantja jote m'ï bëri të gjitha pyetjet e mundshme dhe të imagjinueshme. Madje, edhe me detaje që më futën në siklet.

- Kur hyn këtu brenda, asgjë nuk mund të jetë e sikletshme, - komentova duke qeshur.

- E vura re, por nuk kam hyrë ende plotësisht në rol.

- Eh, mjaft tani. Do të të ketë pyetur se si je me jashtëqitjen.

- Po. Madje më bëri edhe një vizitë paksa të veçantë. Nuk e kuptova mirë arsyen.

- Për të përjashtuar nëse shkaktare të anemisë sate kanë qenë dëmtimet në nivelin e rektumit, - u përgjigja gjithmonë duke

¹ Anemi e shkaktuar nga mungesa e hekurit në organizëm (shën. i përkth.).

qeshur. Kisha arritur të futesha në rolin tim si kirurge dhe kjo më lejonte të fshihja vorbullën e emocioneve që vlonte brenda meje.

- S'ma kap truri se ç'lidhje ka dhembja ime e barkut me disa lloj eksplorimesh... - komentoi me ironi. - Gjithsesi, e vetmja gjë që më intereson të di është nëse kam diçka për të cilën duhet të shqetësohem.

- Duhet ta shikojmë me kujdes se cili është problemi.

- Mirëpo nuk është momenti i duhur. Pas pak duhet të jem në një darkë të organizuar nga shtëpia botuese. Nesër pasdite është prezantimi në Sallonin e Librit. Ah, meqë ra fjala... Pse nuk vjen edhe ti nesër, gjithmonë nëse arrij të shkoj edhe unë? Është në orën pesë. Më pas do të ketë një koktej.

U mbyta mes dëshirës për të shkuar dhe frikës për të shkuar. Ishte patjetër një vendim që nuk mund ta merrja brenda disa sekondave.

- Nuk e di. Varet se kur mbaroj në sallën e operacionit, - u përgjigja pas disa sekondave hezitimi. - Deri kur do të qëndrosh?

- Nuk e kam vendosur ende. Mendoj rreth një javë.

- Atëherë, duke qenë se nuk ke asgjë urgjente, TAC-un dhe, ndoshta, edhe disa analiza të tjera po t'i bëj gjatë ditëve në vijim. Nëse i bëjmë tani duhet të presësh shumë, - u përgjigja pa i ngritur sytë nga stilolapsi që po e rrotulloja me nervozizëm nëpër gishta.

- Ah, mirë. Është e pabesueshme që rastise të kishe turnin sot, pikërisht ti. Nuk kam hyrë kurrë në një spital në jetën time dhe qenka e tmerrshme. Për më tepër, këtu në Paris nuk njoh më askënd. Edhe Pierri është transferuar në Lion.

- Njeh gazetarin që po të pret jashtë. Një i paedukatë në kuptimin e plotë të fjalës.

- Më vjen keq për çka ndodhi. Është pikërisht ai që do të prezantojë nesër librin tim. Ishte mjaft i shqetësuar.

- Po, e kuptoj.

- Sipas teje, mund të shkoj në atë darkën sonte?

- Sigurisht. Ke një anemi kronike. Të gjitha analizat e tjera janë shumë mirë. Fillo merr tabletat e hekurit që do të të dërgoj me Rënenë dhe gjatë ditëve që vijnë do të kërkojmë të kuptojmë se ku qëndron problemi. Nëse nuk do të ndihesh mirë, më telefono dhe takohemi këtu.

- Nuk ke ndryshuar aspak, Liza, - tha duke tundur kokën me një buzëqeshje.

- As ti, gjithashtu.

Kapitulli 3

Zgjedhja e duhur

Ishte vonë tashmë për t'u kthyer sërish te bari në buzë të Senës prej nga m'u desh të largohesha aq papritur. Prandaj, para se të kthehesha në shtëpi, u enda pak rrugëve të “Marais”-ë. Të ecësh nëpër “Marais” në *happy hour* është tamam një zhytje e vërtetë mes kënaqësisë. Baret, restorantet dhe dyqanet gëlojnë nga njerëzit, kryesisht të rinjtë, që bisedojnë, pinë, hanë dhe qeshin... jetojnë. Një jetë aq gazmore, por edhe aq e ndryshme nga ajo që jetojnë disa të tjerë, po në të njëjtën orë, disa kilometra më larg. Megjithatë, atë mbrëmje, nuk kisha nevojë ta kërkoja kënaqësinë në baret e “Marais”-ë. Isha euforike, e lumtur. Gëzimi ishte brenda meje dhe nuk më duhej ta kërkoja diku tjetër.

Kur hyra në shtëpi, Marseli ishte në telefon si zakonisht. Nga toni i zemëruar i zërit, e kuptova që po diskutonte për çështje pune. Që kur ishte bërë drejtor ekzekutiv në ndërmarrjen e tij, edhe ato pak orë që i kalonte në shtëpi ishte pothuajse gjithmonë në telefon. E përshëndeta me një lëvizje të dorës dhe u mbylla shpejt në dhomën time. Ishte shumë i zënë me atë telefonatë për të m'u përgjigjur dhe unë isha e kënaqur. As unë nuk kisha dëshirë të flisja. Kisha nevojë të qëndroja vetëm. Kisha nevojë të mendoja për Xhoin, për atë pasdite të çuditshme, për emocionet e thella që të shkaktojnë gjërat e papritura. Kisha nevojë t'i shikoja sërish të ngadalësuar skenat e atij takimi, të kërkoja domethënien e fshehur pas çdo gjesti të tij, pas çdo vështrimi të tij, pas çdo fraze të tij. Kish nevojë të ridëgjoja tonin e zërit të tij për të kuptuar

domethënien sekrete të çdo fjale të veçantë. Kisha nevojë të rishikoja fytyrën e tij, buzëqeshjen e tij, lëvizjet e duarve të tij, madje edhe veshjen e tij, *Ray-Ban*-ët mbi ballin e tij, çantën e tij prej lëkure të mbështetur në tokë. Të rigjeja një mijë veçori, të cilave nuk u kisha kushtuar vëmendje, sepse çdo veçori mund të ishte e rëndësishme për të kuptuar. Kisha nevojë ta pyesja veten për rrëqethjen që kisha ndier përgjatë kurrizit, ndërkohë që Xhoi zbërthente kopsat e këmishës, ndërkohë që prekja lehtë lëkurën e tij. Rrëqethje që nuk i kisha ndier më që prej asaj kohe... Kisha nevojë të kuptoja se çfarë kishte mbetur nga ne pas gjithë këtyre viteve, si dhe ta pyesja sërish veten, nëse ajo kishte qenë zgjedhja e duhur. Por si mund të arrish të kuptosh nëse zgjedhja e bërë ka qenë apo jo e duhura? Mendoj se duhet t'i përjetosh të dyja dhe vetëm pasi i kemi jetuar ato mund të zgjedhim. Por, për fat të keq, në jetë nuk funksionon kështu. Shpesh në zgjedhjet tona nuk kemi shumë parasysh veten tonë... Kisha nevojë t'i merrja sërish në duar librat e Xhoit dhe të kërkoja aty fraza që i kisha lexuar e rilexuar me mijëra herë dhe që i dija përmendësh. Çdoherë arrija të kapja ndonjë nuancë të re, që më kishte shpëtuar më parë, dhe dëshiroja t'i lexoja dhe rilexoja librat e tij deri në fund të jetës sime. Njerëzit që na rrethojnë janë gjithmonë tejet të mërzitshëm. Të gjithë rendin pas çështjeve banale të jetës së përditshme. Të gjithë mendojnë vetëm për këtë, ndërsa unë, në fakt, do të doja diçka tjetër. Diçka që nuk e di se çfarë është, por, kur lexoj librat e Xhoit, kam përshtypjen se ai e di, ose të paktën, ashtu si unë, është duke e kërkuar.

- Akoma nuk je veshur? - më pyeti Marseli, që u shfaq te dera e dhomës.

- Përse?

- Si përse? Nuk e mban mend që sonte kemi darkën e ndërmarrjes?

- O Zot, e kisha harruar krejt! Dëgjo, jam shumë e lodhur dhe nuk mund të vij. Gjithashtu, nuk dua ta lë Matjënë gjithmonë vetëm.

- Mos sajo justifikime qesharake, - u përgjigj me të njëjtin ton të irrituar që po fliste në telefon pak më parë. - Sot është e enjte dhe Matjëja, nëse e mban mend, shkon në palestër dhe ha darkë jashtë me Zhylienin.

- Po, ke të drejtë. E kisha harruar edhe këtë.

- Nuk mund të mos vish sonte. Të martën miratuam buxhetin. Këtë katërmujor kemi dalë mjaft mirë. E organizova këtë darkë për të falënderuar të gjithë punonjësit dhe për të festuar.

- Mirë, por unë ç'hyj këtu?

- Si ç'hyn ti? Je gruaja ime, apo jo?

- Dhe pastaj?

- Në festë janë ftuar edhe bashkëshortet. Simona, që është grua, do të vijë me të shoqin.

- Nuk e kuptoj se ç'punë kanë bashkëshortet dhe bashkëshortët në darkat e ndërmarrjes.

- Kjo ndodh në të gjitha vendet e botës. Vetëm ty nuk të pëlqen asgjë. Mbi të gjitha, nuk të intereson ajo çka bëj unë.

- Nuk kam dëshirë të grindem sot.

- As unë. Kam dëshirë të dalim dhe të argëtohem. Kam punuar natë e ditë kohët e fundit dhe kam nevojë të dëfrej.

- Të dëfrehesh në një darkë ndërmarrjeje? Në një darkë ku të gjithë shtiren se ndihen mirë së bashku, kur, në fakt, shumë prej tyre do të kacafyteshin?

- Dëgjo, darka sot është në një restorant të bukur, ku hahet mirë dhe flitet për gjëra të gëzueshme. Jeta nuk është gjithmonë një tragjedi. Nuk ka vetëm të sëmurë në prag të vdekjes dhe kirurgë të gatshëm për t'i shpëtuar. Ekzistojnë edhe njerëz të shëndetshëm, që jetojnë, argëtohen dhe ndoshta bëjnë edhe para. Ç'të keqe ka këtu?

- Bota e parasë, siç e di edhe ti, nuk më intereson.

- Je shumë kategorike në arsyetim. Për ty ekziston vetëm e bardha dhe e zeza. Nga njëra anë janë ata që bëjnë gjëra të rëndësishme, si kirurgët, për shembull. Ata që shpëtojnë jetët e njerëzve. Me këtë nuk dua të minimizoj punën që bën. Por për ty, nga ana tjetër janë ata, si puna ime, që merren me punë të panevojshme. Paratë, për shembull.

- Nuk kam thënë kurrë asgjë nga këto. Po i sajoni ti.

- Nuk i ke thënë, por ke lënë të nënkuptohen. Sa për dijeni, ndërmarrja ime ka punësuar katërqind veta. Nuk kuroj sëmundjet e tyre, por shqetësohem edhe unë për jetën e tyre.

- Kush e ka vënë ndonjëherë në dyshim këtë?

- Ti.

- Në çfarë ore është darka?

- Në tetë te “Bonfiger”-i. Për një gjysmë ore duhet të dalim patjetër. Të gjithë do të jenë të veshur në mënyrë elegante.

- Do të më tregosh edhe çfarë duhet të vesh që t’u përshtatet bashkëpunëtorëve të tu? - e pyeta me ton të thatë.

- A mund të mos e përdorësh këtë ton, të lutem? Fatkeqësisht i përkas asaj bote mediokre borgjezësh, ku, fatmirësisht, ti nuk bën pjesë. Një bote që vendos rregulla, të cilave ti nuk u bindesh.

- Dhe të cilave ti u bindesh shumë...

Më vështroi vëngër, por shtrëngoi dhëmbët që të mos përgjigjej.

Zgjidha veshjen më elegante, një fustan të “Caroll”, të zi, të uthitur pas trupit. Këpucët e zeza dekolte, me taka të larta. Vura varësen dhe byzylykun me perla. Kam një numër të tillë veshjesh sa më mjaftojnë për t’u ndërruar çdo ditë përgjatë vitesh të tëra. Më pëlqen t’i blej, edhe pse e di që nuk do t’i vesh kurrë. Sa të çuditshëm jemi ne, njerëzit! Kemi me mijëra kontradikta. Unë më shumë nga të gjithë...

Kur përfundova së veshuri, pashë veten në pasqyrë. Dukësha vërtet mirë. Gati për darkë. Gati sipas rregullave. Në fund, edhe unë bindem pastaj. Ashtu si gjithë të tjerët...

Ishim shumë vonë. Por para se të dilnim i lejoja vetes luksin e një vonese të vogël. Mora librin e Xhoit, që e kisha lënë mbi komodinë, dhe lexova një fragment.

Në faqet e një libri kërkojmë në mënyrë të dëshpëruar veten tonë. Kërkojmë gjithmonë veten tek të tjerët. Por, për disa nga ne, është shumë e vështirë të gjejmë dikë të ngjashëm. Dhe nëse e gjen rastësisht, atëherë nuk ka mundësi të mos dashurohet me të.

Mbylla librin dhe shkova për darkë me Marselin.

Kapitulli 4

Kuptimi i jetës sime

Sapo ishim ulur në tavolinë, pas ceremonialit të zakonshme të përshëndetjeve, kur ndjeva dridhjen e celularit tim. Mendja më shkoi menjëherë te Xhoi, por jo, ishte Rëneja.

- Doktoreshë, më vjen keq që po ju shqetësoj përsëri, por duhet të vini këtu menjëherë.

- Sonte është Vinsenti mjeku i rojës, jo unë. Jam në një darkë, jashtë, - u përgjigja duke u ngritur në këmbë dhe duke u larguar nga tavolina. - Çfarë ka ndodhur?

- E di që është Vinsenti. Ai vetë më kërkoi t'ju telefonoja. Është vetëm dhe kemi një pacient në gjendje mjaft të rëndë.

- Eh, sigurisht... Ia thashë Loranit që Vinsenti nuk është akoma gati që të bëjë mjekun e rojës i vetëm. Gjithsesi, mirë, më thuaj për çfarë bëhet fjalë.

- Është një pacient i ri që ka një hemorragji të aparatit tretës. Nuk po arrijmë t'ia ndalojmë. Duhet të vini urgjentisht këtu, përndryshe ka për të vdekur. - Rëneja nuk e humbiste lehtë qetësinë dhe nga toni i zërit të saj e kuptova që bëhej fjalë vërtet për një rast të rëndë.

- Mirë, po thërras një taksì dhe të telefonoj sërish, - u përgjigja para se ta mbyllja telefonatën. - Duhet të shkoj në spital, është një pacient me hemorragji, - i pëshpërita Marselit.

- Më në fund ia dole mbanë, - komentoi ai me ironi.

- Mos thuaj budallallëqe, të lutem. Është një pacient në prag të vdekjes, - u përgjigja duke e shigjetuar me shikim. - Më falni,

por është një rast urgjent në spital. Më duhet të largohem, - thashë me zë të lartë, duke bërë edhe një buzëqeshje, që duhej të shprehte keqardhje.

- Fatmirësisht që jeni ju mjekët. Çfarë jete bëni... - komentoi Andrea, gruaja e Kybertierit.

- Dhe çfarë jete u imponojnë të tjerëve, - iu përgjigj thatë Marseli.

- Eh, megjithatë ti do të vazhdosh të hash darkë këtu, ndërsa ajo duhet të shkojë të operojë, - u përgjigj aty për aty Andrea.

- Po, ashtu është, por ajo është e lumtur që po ikën, - e dëgjova që u përgjigj pas shpinës sime ndërkohë që po nxitoja drejt daljes.

Me të dalë nga restoranti, ndalova një taksì. Në timon ishte një djalë i ri biond, shumë i ri, që më priti me një buzëqeshje. Ishte nga ata që kanë kënaqësi të shkëmbejnë nja dy fjalë ndërkohë që ngasin taksinë, dhe zakonisht, edhe mua më pëlqen të flas me të panjohur. Më pëlqen të futem në botë të ndryshme nga imja. Por, atë çast, kisha gjëra të tjera për të menduar.

- Jam kirurge dhe duhet të shkoj sa më shpejt të jetë e mundur në spitalin *Sacré Coeur*. Është shtruar një pacient me një hemorragji të fortë.

- Ta hajë dreqi! Po mundohem, - u përgjigj djali. Pallatet e rrugës “Rivoli” filluan të iknin si shigjeta jashtë dritares së taksisë, para se të ndalonim papritur para semaforit të “Hôtel de Ville”.

- Është e kuqe, - tha djali me një ton shfajësues, ndërsa më vështronte nga pasqyra prapashikuese.

- Mundohu të arrijmë shpejt dhe gjallë, - i thashë duke qeshur.

- Po përpiqem, - u përgjigj duke buzëqeshur.

Mora sërish në telefon Rënenë.

- Jam në taksì. Brenda disa minutash do të jem aty. Nga ka filluar hemorragjia?

- Nga stomaku.

- Çojeni në sallën e operacionit, sa të arrij unë.

- Është në sallë tashmë. Mbërriti në Urgjencë në gjendje shoku. Shok hipovolemik². Ishte ndier keq në restorant. I vendosa një sondë të vogël hundo-gastrike dhe pashë që kishte gjak në stomak. Atëherë e dërgova direkt në sallë. Lajmërova mjekun për endoskopinë dhe anezestistin.

- Rruga e përkryer për një “hemorragji të aparatit tretës”.

- Për fat sonte ishte në turn edhe doktoresha Mersier. E provoi në të gjitha mënyrat për t’ia ndaluar hemorragjinë. Adrenalinë, kapëse... Por as ajo nuk arriti ta ndalonte këtë herë. Pacienti vazhdon të humbasë gjak. Kemi bërë tashmë tri qese me gjak.

- Po nga vjen gjakderdhja saktësisht?

- Nga zgavra gastrike. Vihet re një ulcerë e madhe. Mund të jetë tumorale.

- Do të jem aty për pak minuta. Thuaji Vinsentit që ta hapë ndërkohë.

- Mirë.

Kur mbërrita në sallën e operacionit Vinsenti nuk kishte filluar ende të bënte prerjen e lëkurën. Ballin e kishte të mbuluar nga pikla djerse.

- Akoma s’e ke hapur? - e pyeta. Do të doja të shtoja edhe ndonjë epitete jo shumë elegant, por u përmbajta.

- Jo, sa po filloja tani. Faleminderit që erdhe, - u përgjigj duke ngritur sytë nga plani i operacionit.

- Nxito! Në këto raste nuk mund të humbim kohë duke përtypur fjalët.

- Liza, lahu shpejt! Po e humbim pacientin, - tha anezestistja, Pëti, duke më treguar qesen e lidhur me sondën hundo-gastrike të mbushur plot me gjak flakë të kuq. - Sapo e zbrazëm dhe ka akoma gjashtëqind. Kam mbushur katër qese tashmë. Dhe janë gati edhe katër të tjera.

- Sa e ka hemoglobinën? - pyeta.

² Shok hipovolemik, humbje e menjëhershme e volumit të gjakut dhe lëngjeve në organizëm (shën. i përkth.).

- Në analizën e fundit e kishte gjashtë. Por ka humbur akoma gjak.

- Tensioni është në rregull, me sa shikoj, - thashë duke lexuar vlerat në monitor.

- Duhet të keni parasysh që e ka *noradrenalinën*³ tetë.

- Djall o punë! Po përse dreqin nuk më lajmëruat më herët? - pyeta duke u kthyer nga Vinsenti.

- Mendova që Mersier do të arrinte ta ndalonte hemorragjinë, - tha Vinsenti kokulur.

- Sipas meje është një ulcera neoplastike. Dhe në rastet e tumoreve duhet një kirurg, - ndërhyri Mersier, e cila deri në atë çast kishte qëndruar në heshtje.

- Ah, qenke këtu, edhe ti? - thashë.

- Jam këtu që prej dy orësh. Nuk arrita ta ndaloja hemorragjinë. Në kësi rastesh është kirurgu që duhet të mendojë, - vazhdoi Mersier, gjithmonë me një ton debatues.

- Mund të më lajmëronit më herët.

- Kisha një copë herë që po u thosha të të thërrisnin, - u përgjigj menjëherë Mersier.

- Nuk arritëm t'ju gjenim dhe nuk doja t'ju shqetësoja, - u përgjigj me gjysmë zëri Vinsenti.

- Nuk doje të më shqetësoje? Por a e kupton se ky është duke vdekur? - pyeta e xhindosur duke u drejtuar te lavamani. Para çdo ndërhyrjeje kirurgjikale të gjithë anëtarët e ekipit duhet të lajnë duart me një furçë dhe jod për disa minuta, duke ndjekur rregullat e rrepta të dezinfektimit. Megjithatë, është e qartë se, nëse një pacient është duke vdekur nga hemorragjia, çdo sekondë merr një rëndësi parësore dhe ritualet e sterilitetit nuk mund të respektohen. I shpëlava shpejt duart dhe infermierja e sallës më veshi përparësen dhe dorezat me shpejtësi. Sapo ia hapa barkun

³ Noradrenalina është hormon ose neurotransmetues që prodhohet dhe çlirohet nga gjëndra surrenale, mbiveshkore, dhe fundet nervore të sistemit nervor qendror (shën. i përkth.).

e identifikova menjëherë shkakun e gjakderdhjes. Prekej me dorë një dendësim në nivelin e zgavrës gastrike. Mund të bëhej fjalë për një ulcerë, por nuk mund të përjashtoja as një tumor. Stomaku ishte i mbushur me gjak që tejdukej nga paretet e trasha të tij, madje edhe leqet e zorrëve në pjesën fundore lejonin të dukej ngjyra e errët e koagulimeve brenda tyre. Lidha menjëherë arterien e majtë gastrike, por gjakderdhja nuk po ndalej. Atëherë hapa ligamentin gastro-kolik për të bërë të mundur qasjen tek epiplonet⁴ në kavitetin e prapmë. Pareti gastrik i pasmë ishte ngjitur pas pankreasit dhe për një çast pata parandjenjën e keqe se bëhej fjalë për një tumor dhe, për më tepër, të paoperueshëm. Në këtë rastin e fundit pacienti do të vdiste brenda disa orëve, dhe unë nuk mund të bëja asgjë. Vetëtimthi mendova se, nëse do të ishte vërtet një tumor, ndoshta ishte më mirë kështu. Tumori i stomakut te një pacient i ri ka një prognozë shumë të rëndë. Kushedi, ndoshta do të ishte më mirë të vdiste menjëherë sesa të vuante muaj të tërë duke pritur vdekjen. Por kush mund ta thotë këtë? Jeta është jetë, sido që të jetë. Megjithatë, detyra jonë si kirurgë është të luftojmë deri në fund për ta shpëtuar...

Menjëherë më pas, mendova se mund të hiqja pjesërisht stomakun pa shkaktuar probleme. Me shumë mundësi mund të ishte një ulcerë e madhe. Preva duodenin dhe stomakun me një suturatriçe mekanike, pastaj, duke vazhduar gjithnjë me të njëjtin instrument, bëra anastomozën. Gjakderdhja ndaloi. Pacienti ishte gjallë dhe do të vazhdonte të jetonte.

Gruaja e tij po më priste e ulur në një ndenjës jashtë sallës së operacionit. Sapo më pa u ngrit menjëherë në këmbë dhe erdhi drejt meje. Ishte shumë e lezetshme, me lëkurë të çelët të shndritshme dhe me tipare të rregullta. Flokët i kishte biondë, të

⁴Strukturë e peritonit, membrana që mbështjell organet e brendshme të barkut (shën. i përkth).

gjatë dhe të drejtë. Dukej si vajzë e vogël. Mbante veshur një bluzë të puthitur pas trupit dhe një palë xhinse të ngjitura e të çara aty-këtu sipas modës së momentit. Në njërën anë të hundës kishte një *piercing* dhe në kyçin e dorës nja dhjetë byzylykë, ashtu si vajzat e vogla, të cilat bëjnë garë në shkollë se kush ka më shumë byzylykë.

- Jam Liza Baldini, kirurgia.

- Arritët t'ia ndalonit hemorragjinë? - më pyeti duke m'u afruar me sytë e kuq nga të qarët dhe të zgurdulluar nga frika.

- Po, tani nuk ka më gjakderdhje.

- Oh, Zot i madh... Faleminderit... E dini, ndodhi gjithçka ashtu papritur. Ishim në restorant kur e ndjeu veten keq. Nuk po kuptoja asgjë. Për fat, dikush lajmëroi urgjencën. Jemi nga Reimsi. Jemi me pushime këtu. - Fliste shpejt, duke i ngrënë fjalët, dhe ndërkohë luante me mbajtësen e çelësave, që e rrotullonte me nervozizëm nëpër gishta.

- Më vjen shumë keq.

- Domethënë arritët t'ia ndalonit hemorragjinë? O nëna ime... Në fillim doktoresha më tha se edhe mund të vdiste... E dini, kështu papritur, je me pushime, në restorant dhe pas dhjetë minutash...

- Eh, ashtu është...

- Për fat gjithçka shkoi mirë, - tha duke marrë frymë e lehtësuar.

- Shkaku i hemorragjisë ishte një ulcerë gastrike. I hoqëm një pjesë të stomakut.

- Domethënë tani është gjithçka në rregull?

- Po. Gjithçka në rregull. Si po thosha, duhet të bëjmë një ekzaminim histologjik mbi këtë ulcerë.

- Mund të jetë diçka tjetër? - pyeti duke i hapur akoma më shumë sytë ngjyrë gri.

- Nuk besoj, por do ta dimë saktësisht kur të kemi rezultatet e anatomisë patologjike. Tani duhet të kënaqemi që arritëm të

ndalonim gjakderdhjen. - Kisha disa dyshime rreth kësaj diagnoze, por përse t'ia thosha atë mbrëmje? Sidoqoftë, unë stomakun e preva. Hemorragjia u ndalua. Më pas, kushedi...

- Po, keni të drejtë.

- Tani është në terapi intensive. Gjendja është e stabilizuar, por, gjithsesi, duhet të jetë nën kontroll gjatë orëve të para pas operacionit. Ju kthehuni në shtëpi dhe flini.

- Faleminderit për gjithçka! Kjo është mbarësia ime. Funksionoi, - tha duke më treguar mbajtësen e çelësave që mbante në dorë. Ishte një lepurush i vogël prej pelushi kaf me një fjongo të kuqe. - Më quajnë Zhyli. Mund t'ju përqafoj?

- Si jo, patjetër.

Më rroku për qafe si një fëmijë. Ndjeva faqen e saj të lagur kur preku timen. Në disa përqaftime përfshihet gjithçka që është shumë e vështirë të përshkruhet me fjalë. Në të ndihet frika, shpresa, ankthi i orëve të gjata të pritjes. Aty janë mijëra hapat e përshkuar, sa para e prapa, në korridorin e gjatë, jashtë sallës së operacionit. Janë kujtimet që shpërfaqen me ëmbëlsinë këmbëngulëse të gjërave të humbura. Është mirënjohja për ata që, të paktën për momentin, të kanë ridhënë të ardhmen...

Këto janë çaste të mëdha për një kirurg. Ndihehesh i rëndësishëm, i domosdoshëm. Dhe ne, njerëzve, na pëlqen të ndihemi të rëndësishëm, të domosdoshëm. Kemi nevojë të mendojmë, herë pas here, se jeta jonë ka një kuptim.

Vendosa të shkoj në shtëpi më këmbë, edhe pse ishte shumë vonë. Kisha nevojë të ecja, të ecja shpejt, të vrapoja, a thua se, duke shpejtuar hapin, mund ta lija këtë botë pas krahëve dhe të shkoja në një tjetër... që kurrë nuk e kam kuptuar mirë se ku ndodhet...

Kishte kaluar pak mesnata. Baret ishin akoma të mbipopulluara. Njerëz të gëzuar, të ulur në tavolinat jashtë, bënin shaka, qeshnin, pinin birra.

Kapitulli 5

Jeta që do të donim...

Kur dola nga shtëpia, mëngjesin tjetër, isha e bindur, më se e bindur, që nuk do të shkoja në Sallonin e Librit. Por nga ora dhjetë ndërsa isha duke operuar, mendova se, në fund të fundit, bëhej fjalë vetëm për prezantimin e një romani. Patjetër që duhet të kishte shumë njerëz, por, po të qëndroja nga rreshtat e fundit, nuk do të më vinin re. Në mesditë ndryshova sërish mendje dhe pyesja veten se mos isha krejt e marrë që mendoja të shkoja të takoja Xhojin. Por, kur erdhi ora katër e pasdites nxitova me vrap drejt metropolitanes, duke mallkuar veten që nuk pata mundësi të kaloja nga shtëpia për t'u ndërruar.

Kur mbërrita, Xhoi dhe Rimboja ishin në podium, të ulur në dy poltrona qesharake me lëkurë vishnje, gjoja të stilit barok. Para tyre kishte një tavolinë, mbi të cilën ishte vendosur një kopje e romanit mbështetur te një pult leximi. Salla ishte e tejmbushur. Shumë ishin në këmbë dhe shumë të tjerë të ulur përtokë. Për fat gjeta një ndenjësë në një nga rreshtat e fundit të sallës. Rimboja sapo kishte mbaruar së foluri dhe ishte duke i zgjatur mikrofonin Xhoit.

- Pa humbur më shumë kohë, po ia kaloj tani fjalën Zhan-Luit, në mënyrë që të lëmë pak hapësirë edhe për pyetjet tuaja në fund.

Pasoi një duartrokitje e gjatë. Xhoi dukej shumë i emocionuar. Mbylli dhe rihapi disa herë mikrofonin para se të fillonte të fliste.

- Jam i lumtur që jam sonte këtu, edhe për faktin që ngjarjet

e romanit ndodhin këtu, në qytetin tuaj, i cili është edhe qyteti im. - Bëri një pauzë të shkurtër. Nxori celularin nga xhepi dhe e vendosi mbi tavolinë. - Jam lindur në Paris dhe kam kaluar këtu fëmijërinë dhe adoleshencën time... Vitet më të bukura të jetës sime.

M'u mblodh një komb mallëngjimi në grykë, që po më zinte fytyrën. U mundova të rrëshqisja akoma më shumë nga ndenjësja për t'u fshehur pas kokave që ishin para meje. U gëzova kur vura re se zotëria i ulur para meje ishte tejet i gjatë dhe trupmadh.

- Protagonisti i romanit është një burrë rreth të dyzetave, në kulm të suksesit profesional. Një burrë që përjeton atë çka Cocteau-ja do ta përkufizonte si "vështirësia e të qenët". Tani po ju lexoj dy pasazhe, që ravijëzojnë mjaft mirë figurën e tij.

Ndoshta kishte ndjekur shumë ëndrra, kishte fituar shumë prova... dhe, në dyzet vjeç, ishte një njeri që i kishte bërë tashmë të gjitha. Një njeri i detyruar t'i nënshtrohej fatit si gjithë të tjerët. Atë të përsëritjes. Të përsëriste deri në pafundësi. Por ai, nuk mund ta bënte këtë.

E ndërpreu për një çast, kroi zërin, pastaj vazhdoi:

Pasionet janë motorët e jetës dhe sa më të furishme të jenë aq më shpejt vrapohet. Dhe nëse vrapohet shpejt, atëherë mbërritja bëhet e lehtë. Vetëm se, në njëfarë pike, pasi i ke kaluar të gjitha pikësynimet, mund të ndodhë të pyesim veten ku duam të mbërrijmë akoma...

Po, ishte pikërisht kjo pika në të cilën kisha arritur edhe unë. Ky njeri, të cilin nuk e kisha parë prej vitesh dhe për të cilin nuk dija më asgjë, përveç që kishte një dhembje abdominale në të djathtë dhe hemoglobinën 9 gramë, ishte personi i vetëm në botë

që i njihte më mirë mendimet e mia. Në fjalët e tij gjeje atë trishtim të mprehtë që mbushte ditët e mia, atë nevojë të vazhdueshme për të vrapuar pa arritur kurrë diku, atë ndjesi shtypëse paplotësie, të cilën asgjë nuk arrinte ta mbushte.

- Është një histori dashurie, e lindur në bankat e shkollës, e ndërprerë nga ngjarjet, por asnjëherë e përfunduar, - filloi sërish të flasë Xhoi pas një pauze të shkurtër. - Historia e një dashurie të pamundur, që mbijeton nën hirin e kohës dhe që shpërthen herë pas here, me të njëjtën forcë dhe me të njëjtën çmenduri të dashurive adoleshente, duke vënë në pikëpyetje jetën e tyre.

“Këtë herë nuk do të ndodhë”, mendova ndërkohë që mundohesha të rrëshqisja sa më poshtë në ndenjëse.

- Kur flitet për dashurinë, - vazhdoi Xhoi, - bëhet gjithmonë e njëjta pyetje, së cilës askush nuk di t’i japë një përgjigje. Cili është kufiri mes rënies në dashuri dhe dashurisë? A ekziston kalimi nga njëra tek tjetra? Dhe nëse e para është e destinuar të mbarojë, dhe e dyta është tashmë një falimentim në vetvete, si mund të shpëtohet një histori dashurie nga konsumimi i kohës?

Qëndroi disa sekonda në heshtje duke parë nga publiku, si të priste një përgjigje prej tyre.

- Ndoshta e vetmja mundësi mund të jetë krijimi i një historie dashurie ndryshe nga e zakonshmja, si protagonistët e këtij romani. Një histori dashurie ku njëri ndjek me vrap tjetrin, pa ia dalë kurrë mbanë ta arrijë. Dhe dëshira, pavarësisht mungesës së tjetrit, mbetet gjithmonë e gjallë. Historitë e dashurisë që nuk fillojnë kurrë, janë ato që vazhdojnë përgjithmonë...

Ishte e trishtë ajo çka po thoshte Xhoi, por, në fund të fundit, kjo ishte dashuria jonë.

- Edhe në këtë roman gjejmë të njëjtin trekëndësh dashuror. Bashkëshortja është një grua tejet e ëmbël, por e pazonja për të kuptuar fantazmat dhe fiksime të tij. Tjetra është një shoqe e vjetër shkolle. *Por a është vërtet dashuri? Mund të gjendet te një tjetër përgjigje për trishtimin e jetës?*

Si është e mundur të mendoja që në jetën e Xhoit nuk kishte një tjetër grua, pas gjithë atyre vitesh? Kishte dhe ishte ajo, jo unë, protagonistja e romanit të tij dhe e jetës së tij. Në fund të fundit, ajo jona ishte një prej atyre historiçkave të lindura në bankat e shkollës. Histori që pothuajse të gjithë i kanë përjetuar dhe i kanë harruar menjëherë më pas. Një histori e largët, e errësuar nga mjegulla e kujtimeve, me imazhe të deformuara nga filtrat e nostalgjisë, e cila i bën të duken gjithmonë më të bukura, edhe ato që vetëm të bukura nuk kanë qenë kurrë. Xhoi nuk shkruante për ne. Ai shkruante romane. Histori të mrekullueshme për të shituar librat. Fraza të fuqishme për t'i bërë lexuesit për vete. Por pastaj vjen jeta e vërtetë. Dhe në të nuk isha unë, por një tjetër. Dhe, ndoshta, ishin të lumtur bashkë. Siç isha unë me Marselin. Siç isha unë...

- Ndoshta, - filloi sërish të flasë Xhoi, - nuk është edhe aq e rëndësishme ta dimë. Dashuria i jep entuziazëm jetës sonë. Mendjelehtësi. Na lejon të parandiejmë mundësinë për të kthyer faqe, për të imagjinuar një jetë të ndryshme nga jona. Na ysht të mendojmë se mund t'ia mbathim nga një jetë, e cila nuk është aspak ajo që do të donim...

Kapitulli 6

Metamorfozat

Do të thosha se tregove pak si shumë. Le ta lëmë me kaq, përndryshe, askush nuk ka për ta blerë librin, - komentoi me ironi Rimboja, ndërkohë që po zbriste nga podiumi me një mikrofon në dorë. - Dhe tani, nëse ka dikush ndonjë pyetje, koha e mbetur është në dispozicionin tuaj.

U ngrit menjëherë në këmbë një grua e re, e ulur në rreshtin e parë. - Më quajnë Denizë Lërua. Jam gazetare e *France Culture*. Kam një pyetje të natyrshme, që duhet t’jua kenë bërë tashmë kushedi sa herë. Bëhet fjalë për një roman autobiografik?

- Romanet janë gjithmonë autobiografike. Kur dikush shkruan, shkruan për veten, - iu përgjigj menjëherë Xhoi. Qëndroi disa çaste në heshtje, duke e rrëshqitur gishtin tregues mbi buzën e poshtme. - Megjithëse, gjatë kohës kur shkruaja kuptova se protagonistja, ajo që mendoja se ishte alter egoja ime, që në fakt shumë ndryshe nga unë. Në disa momente madje, rezulton e padurueshme. Ndërsa në disa raste të tjera e dua, sepse jam unë vetë. Në disa pasazhe, bëhem herë njëri, herë tjetri. Nuk është kurrë e lehtë të kuptojmë se kush jemi. Mendojmë se jemi në një lloj mënyre dhe me gjasë jemi krejtësisht të ndryshëm. Siç e thotë edhe Pirandello, jemi “Një, askush dhe njëqind mijë”⁵.

Mori sërish në dorë romanin, e hapi në një faqe, pastroi zërin dhe filloi të lexojë:

⁵ *Uno, nessuno e centomila* është titulli i romanit më të famshëm të Pirandello-s, ku në qendër është tema e krizës së identitetit, identitetet e shumëfishta të gjithsecilit (shën. i përkth.).

- E keni pyetur ndonjëherë veten se cili jeni në të vërtetë? Çfarë ka të vërtetë te ju, në atë çka jeni, në atë që mendoni se jeni? Çfarë ka të rreme, të shtirë, të ndrydhur me vështirësi?

- Besoj se gjithsecili prej nesh krijon një imazh të vetvetes. Dhe e kalojmë jetën pastaj duke u munduar të jemi sa më shumë të ngjashëm me atë çka kemi menduar se jemi. Por, pastaj, kushedi se cilët jemi në të vërtetë...

Duartrokitjet që pasuan nuk kishin të ndalur. Vendosi librin mbi tavolinë dhe mbushi një gotë me ujë. Në fytyrë i dallohej kënaqësia e dikujt që dëshironte të arrinte aty, në atë podium, dhe që ia kishte dalë mbanë.

- Më quajnë Ameli Duran dhe jam gazetare e *France Soir*. - Ishte një mesogrua, me një cullufë ngjyrë të kaltër mes flokëve gri, që binte mjaft në sy. - Duke qenë se na ngacmuat me një pyetje, tani do të doja t'ju bëja unë një të tillë. Sipas jush, çfarë na shtyn të krijojmë një imazh për veten?

- Pyetje e bukur! Përgjigjen e kësaj pyetjeje e gjeta ndërsa shkruaja, - iu përgjigj menjëherë Xhoi. - Në krijimtari, mendja çlirohet nga kontrolli ynë racional. Futet brenda labirinteve tona më të errëta dhe arrin në qoshet tona më të fshehta... Ndërkohë që shkruaja, kuptova rëndësinë e të kaluarës sime dhe kryesisht të cikatricave të mia, që më kanë bërë atë që jam sot. - Lëvizte vazhdimisht mbi poltronë në kërkim të një pozicioni që nuk po arrinte ta gjente dhe shprehte në mënyrë të qartë shqetësimin e tij.

E dija se për çfarë po fliste Xhoi. E dija se çfarë fshihej pas atyre fjalëve. Mendova për Zhylinë, një natë më parë. *Piercing*-un e saj në hundë, xhinset e grisura. Lepurushin fatsjellës. Sa kishte ndryshuar ajo vajzë e re brenda një nate? Sa do ta ndryshonin ditët që do të vinin më pas? Sa më kishin ndryshuar mua disa ngjarje

të jetës sime? Sa kishte ndikuar e kaluara ime mbi mënyrën time të sjelljes, mbi atë që kërkoja me çdo kusht të dukesha e fortë, e paprekshme, e padukshme? E padukshme...

- Ne jemi rezultat i jetës sonë, - vazhdoi Xhoi. - Jeta, me ngjarjet saj që pasojnë pareshtur njëra-tjetrën, na mbrun ditë pas dite, dhe ditë pas dite na bën një person të ndryshëm. Në mënyrë të vazhdueshme gjendemi përpara një produkti të ndryshëm të vetes sonë, që na lë të përhumbur, me dëshirën për të mbrojtur identitetin tonë të vërtetë e unik. Atëherë, na duhet t'u dorëzohemi metamorfozave tona, ndryshimit të mendimeve tona në kohë, ashtu siç jemi të detyruar të pranojmë ndryshimet në fytyrën tonë dhe në tiparet tona.

Pasoi një duartrokitje e gjatë, ndërkohë që unë po reflektoja mbi domethënien e kësaj përgjigjeje të çuditshme. Eh, ashtu është, gjithçka ndryshon. Edhe ne ndryshojmë.

- Jam Filip Bernar, gazetar i *Figaro-s*, ndërhyri me një zë të mprehtë një zotëri në moshë, i ulur në një rresht para meje, duke më ndërprerë papritur mendimet e mia. Kishte një pamje fisnike, i veshur me një kostum dopiopet gri elegant dhe me syze ngjyrë ari. - E kam lexuar tashmë romanin tuaj dhe do të doja të dija mendimin tuaj lidhur me mundësinë që dy persona, që kanë vite larg, të vazhdojnë ta duan njëri-tjetrin. Dhe nëse takohen sërish, a mund të kthehet gjithçka si më parë? A nuk ju duket joreale si histori? Ju sapo thatë që ndryshojmë në mënyrë të vazhdueshme. Si mund të duam ende të njëjtin person, i cili ndërkohë nuk është më i njëjti? Të gjithë e dimë se dashuritë mbarojnë. Të gjitha dashuritë mbarojnë.

Prita pa marrë frymë përgjigjen e Xhoit.

- Përse joreale? Kush mendon se kjo histori është joreale, atëherë besoj se nuk e ka njohur kurrë dashurinë e vërtetë, - u përgjigj Xhoi me vendosmëri. Vura re fytyrën e pakënaqur të gazetarit ndërsa zinte vend të ulej. - Dashuria është emocion,

poezi, mrekulli. Dhe mrekullitë nuk shpjegohen. Ajo nuk u bindet ligjeve të arsyes dhe as parimeve të fizikës. Jeton në një hapësirë të sajën, ku nuk ekziston koordinata e kohës. E shkuara mund të kthehet brenda një çasti në të tashme dhe e tashmja sërish e shkuar. - Ndërkohë që fliste, endej me vështirim në mes të publikut dhe në njëfarë pike sytë tanë u kryqëzuan për një çast, para se të arrija të fshihesha përsëri pas kokave që ishin para meje.

- Ndërsa unë, në fakt, do të doja të dija nëse bëhet fjalë për një histori të vërtetë.

Ishte një zonjë bionde, me flokët e mbledhur lart topuz dhe me një kostum jeshil të ndritshëm që binte në sy.

U gëlltita dhe ndjeva një shtrëngim në gjoks. Pyeta veten nëse ishte një ëndërr...

- Besoj se kjo është pyetja që duan të bëjnë të gjithë, - ndërhyri Rimboja. - Jemi të gjithë të paduruar të mësojmë nëse gruaja për të cilën flisni në roman është një person real. Qoftë edhe një shoqe klase e dikurshme.

- Ndoshta, - u përgjigj Xhoi, duke shmangur pyetjen me një buzëqeshje. - Por, ashtu siç e shkruaj në romanet e mia, dashuria është gjithmonë një iluzion. E vetmja gjë e rëndësishme është që ky iluzion të bën të lumtur.

- Duhet ta mbyllim këtu, - tha Rimboja duke u drejtuar shpejt drejt podiumit.

- Mund të bëj edhe një pyetje të fundit? - pyeti me një ton lutës një vajzë brune me balluke.

- Vetëm nëse është diçka shumë e shkurtër, - u përgjigj Rimboja duke parë orën.

- Shumë shkurt. Në romanet tuaja, ju flisni gjithmonë për vetminë. Por ju lini përshtypjen e një personi me një karakter tejet të hapur. Me një fjalë, ka një lloj mospërkimi mes jush dhe shkrimtarit.

- Jemi të çuditshëm ne njerëzit! Jemi gjithë kontradikta. Kush shkruan ndien nevojën të mbyllet i vetëm në një dhomë, për t'i treguar kompjuterit jetën me gjithë të tjerët, të cilën nuk është i aftë ta jetojë. Gjithsesi, diskutimi do të na merrte shumë kohë... - tha duke u kthyer nga Rimboja.

- Jo s'ka problem... vazhdo, përfundoje.

- Mirë. Gjërat duhen parë gjithmonë sipas disa perspektivave të ndryshme. Është e vërtetë që të shkruash një roman do të thotë të qëndrosh i vetëm brenda një dhome, por do të thotë edhe të imagjinosh një histori, ku të tjerët mund të gjejnë vetveten. Kthehet, pra, në një tentativë për të komunikuar sa më gjerë, me një numër më të gjerë personash sesa ai në rrethin tonë të vogël të përditshëm.

- Do të thosha se është një objektiv i guximshëm, - komentoi Rimboja.

- Ashtu është, dhe shpresoj t'ia kem arritur. Shpresoj që në faqet e romaneve të mia të keni gjetur veten tuaj, mendimet tuaja, shpresat tuaja, zhgënjimet tuaja, si dhe ngjarjet e jetës suaj, të cilat, në fund të fundit, janë shumë të ngjashme për të gjithë ne.

Pasoi sërish një duartrokitje e gjatë, në fund të së cilës Xhoi u zhduk mes publikut. E pashë tek drejtohej nga unë, duke hapur rrugën me vështirësi.

- Jam i gëzuar që erdhe. Tani do të ketë një koktej në një lokal këtu afër.

- Më merr ne telefon kur të kesh mbaruar. Duhet të të them diçka lidhur me analizat që do të bësh.

- Hajde edhe ti. Pastaj flasim me qetësi, si dy miq të vjetër...

- E po mirë. Duhet të të shpjegoj disa gjëra në lidhje me ekzaminimin e nesërm. - Kisha një pretekst të mirë për të qëndruar. Edhe me veten time.

Kapitulli 7

Xhelozia

Ndërkohë që prisja Xhoi, erdha rrotull Sallonit të Librit. E adhuroj të qëndroj në mes të librave. I adhuroj libraritë, bibliotekat, stendat e librave në mes të rrugës. Do të qëndroja mes librave gjithë ditën e gjithë natën. Madje edhe ditën tjetër, dhe atë më pas dhe atë akoma më pas. Dhe të gjitha ditët e tjera. Do t'i lexoja të gjithë, nga i pari tek i fundit dhe, nëse arrija në fund, do të rifilloja nga e para. Më pëlqen të njoh mendimet e të tjerëve dhe ndoshta të gjej një mendim timin, në ndonjë faqe. Më bën të ndihem më pak vetëm... Në fakt, atë ditë nuk arrita të lexoja as edhe një rresht. Isha shumë e emocionuar dhe nuk arrija të mendoja për asgjë tjetër veç Xhoit.

Kur ai u kthye pas një gjysmë ore, unë isha në shoqërinë e një gruaje të re, shumë elegante. Kishte një fytyrë të bukur, me tipare të rregullta, sytë e kaltër dhe lëkurën e çelët, që i bënte kontrast me flokët pis të zinj. Mbante veshur një kostum blu të puthitur, që nxirrte në pah trupin e hollë dhe këmbët e gjata të përkryera.

- U mërzite? - pyeti Xhoi tërë kujdes.
- Ndihem mirë mes librave. Është vendi im i parapëlqyer.
- E di. Po ju prezantoj. Emili... Liza. Liza është një shoqja ime e vjetër e liceut, -shtoi duke u kthyer nga Emilia.

Ia shtrëngova dorën me një buzëqeshje që doja të ishte e sinqertë, duke u munduar të fshihja dhembjen që ndieja. Nuk m'u desh të prisja gjatë për të pasur një përgjigje për pyetjet e mia. Ja, gruaja. Ndërsa unë, ashtu sapo e kishte thënë Xhoi, isha një

shoqe e vjetër shkolle. Nuk ekzistojnë dashuritë e përjetshme. Ekzistojnë vetëm shokët e rrugëtimit, të cilët qëndrojnë me ne për disa stacione, pastaj vazhdojnë më tej udhëtimin e jetës së tyre së bashku me të tjerët.

- Emilia nuk flet mirë frëngjisht. Ti, Liza, flet anglisht?

- Po.

Në atë çast u bashkua me ne edhe Rimboja.

- Zhan Klod, kjo është Liza, shoqja ime kirurge.

- Kënaqësi, - tha Rimboja duke më shtrënguar fort dorën. - Kërkoj ndjesë për dje. Nuk u solla mirë. Por kur Zhan-Lui gati humbi ndjenjat u tmerrova.

- Nuk ka problem, - u përgjigja duke bërë edhe një buzëqeshje të sforcuar.

- Lokali është dy hapa larg prej këtu. Po ju prij, - tha duke ecur shpejt para nesh.

Emili i kërkoi diçka Xhoit dhe ai iu përgjigj, pastaj vazhduan të flasin midis tyre në një mënyrë pothuajse të rrëmbyer. Flisnin shpejt dhe unë arrija të kuptoja vetëm disa fjalë aty-këtu dhe ndërkohë pyesja veten se çfarë drejtin erdha të bëja atë pasdite aty. Ç'hyja unë me ta? Dhe, për më tepër, çfarë prisja tjetër? Ishte normale që Xhoi të kishte jetën e tij, ashtu siç e kisha edhe unë timen. Kishte kaluar shumë kohë që atëherë. Ngadalësova hapin për t'i lënë të lirë të flisnin. Duhej të gjeja një pretekst për t'u larguar.

- Ku je, Liza? - pyeti Xhoi duke u kthyer mbrapa me shumë mirësjellje.

- Këtu jam. Doja t'ju lija të flisnit të qetë.

- Çfarë thua! Nuk ka asnjë sekret. Po flisnim vetëm për disa çështje të punës.

- Nuk ke përse shfajësohesh... - u përgjigja duke lënë të kuptohej një nënkuptim, që Xhoi nuk e kapi.

- Dje zbulova që je një kirurge e famshme.

- Kush ta tha?

- Rimboja bëri disa telefonata, për të marrë të dhëna mbi personin që do të më operonte, nëse do të lindte nevoja. Dhe të gjithë i konfirmuan se isha në duar të sigurta. Në më të mirat.

- Po e ekzagjeron tani.

- Nuk po e ekzagjeroj. Këtë i thanë. Nuk ishte shumë e kënaqur me punën tënde herën e fundit kur u pamë, por më duket se gjërat kanë gjetur vendin e tyre.

- Po, për fat të mirë. Por nuk ka qenë e lehtë. Jam grua dhe kirurgjia vazhdon, edhe sot, të jetë një punë për burra. Për shumë gra, kirurgjia vazhdon të jetë një ëndërr e paarritshme.

- Mendoja se gjërat kanë ndryshuar.

- Jo shumë. Gratë sot mund ta ushtrojnë kirurgjinë, por vetëm nëse ua lënë burrave rolin prestigjioz. Asnjë karrierë universitare, asnjë pozicion të lartë. Shpesh i syrgjynosin në fushat më pak prestigjioze të kirurgjisë. Herniet, kirurgjia ambulatorë... Unë megjithatë, edhe pse jam grua, doja të ushtroja kirurgjinë onkologjike dhe doja ta bëja edhe në mjedisin universitar, sepse më pëlqen edhe të studioj, të shkruaj... Një ëndërr e pamundur. Por gjithçka është e mundur nëse do vërtet diçka...

- Nuk kam pasur dyshime që do ta arrije, - komentoi Xhoi.

- Le të themi që më eci mirë. Në spitalin *Sacré Coeur*, pata fatin të takoja Loranin, drejtorin tim aktual, i cili më lejoi të bëja atë çka doja. Isha shumë e re dhe kisha gjithë jetën përpara meje për të realizuar ëndrrën time. Dhe ia dola mbanë...

Nuk më pëlqen të mburrem për sukseset e mia profesionale. Nuk e duroj as kur e bëjnë të tjerët, prandaj mundohem gjithmonë të mos bie në ca shfaqje dobësie të marra. Mendoj se nevoja për të treguar për veten është, në të vërtetë, një nevojë për miratim, pra, në fakt, një pranim i pasigurisë. Gjithmonë kam menduar që çdokush duhet t'i shijojë brenda vetes sukseset profesionale. Besoj se kënaqësia më e madhe është pikërisht t'i tregosh vetes

sate kapacitetet e tua, është një kënaqësi shumë më e madhe sesa ajo që rrjedh nga duartrokitjet e të tjerëve. Por kjo është vetëm mënyra ime për t'i parë gjërat dhe shpesh mënyra ime nuk përputhet me ato të të tjerëve... Megjithatë, në atë çast, ndjeva edhe unë nevojën për t'i treguar Xhoit për sukseset e mia. Ndoshta kjo nevojë për të folur për veten ishte prova e dobësisë sime. E asaj xhelozie të marrë që po më torturonte.

- Më bëhet qejfi që ke takuar personin e duhur, i cili të ka vlerësuar, - tha Xhoi duke me rënë në sup me përzemërsi.

- Le të themi që unë i nevojitem atij dhe ai mua. Gjithsesi, në fund u morëm vesh.

Po, isha e zonja. Shumë më e zonja sesa bukuroshja e tij Emili.

Kur mbërritëm te lokali, salloni elegant ishte tashmë plot. Të binin menjëherë në sy llambadarët madhështorë prej kristali, që vareshin nga tavani, si dhe pasqyrat e mëdha ngjyrë ari, që vishnin paretet e sallës. Në tri anët e sallës shtriheshin tavolinat e koktejit me mbulesa të bardha sateni dhe kompozime elegante lulesh. Shampaña shërbehej nga kamerierë me veshje të bardha. Njoha disa gazetarë dhe nja dy shkrimtarë mjaft të njohur, Furnie, këshilltar për kulturën i Parisit, dhe Vinsenti, drejtori i *Le Figaro*-s, të cilët dilnin shpesh në televizor. Të tjerët nuk i njihja, por, sigurisht, i përkitnin botës së kulturës dhe asaj editoriale.

- Liza, më vjen keq që do të të lë pak vetëm, - tha Xhoi duke më zgjatur një gotë shampanjë, - por ne duhet të bëjmë tani një xhiro rreth sallës për të përshëndetur disa persona.

Ne... E ndoqa me shikim ndërsa rrotullohej i sigurt nëpër sallë bashkë me Emilinë e tij elegante dhe të gjithë mezi prisnin të flisnin me ta. Ndihejshin mirë ndërsa kalonin nga një grup tek tjetri, duke folur me të gjithë dhe duke ua shtrënguar duart të gjithëve. Në fund të fundit, çfarë mund të prisja tjetër? Xhoi nuk ishte më Xhoi i dikurshëm. Ishte një shkrimtar i famshëm tashmë, me një grua të mahnitshme dhe një mijë persona prisnin në akth

për ta njohur më në fund. Atëherë, përse kishte këmbëngulur aq shumë që të vija edhe unë?

Kur u kthye, pas një kohë që m'u duk e pafund, ishte mjaft i elektrizuar. Po prisja gjithë ankth çastin për t'i vjellë përsipër tërbimin e xhelozisë sime.

- Më fal që të bëra të prisje, por janë marrëdhënie pune, të cilave nuk mund t'u shpëtoj.

- Po sigurisht... por e di, unë këtu nuk njoh asnjëri.

- Ke të drejtë, ndjesë.

- Erdha për të të shpjeguar disa gjëra lidhur me analizat e tua nesër. Por nuk më duket se është vendi i duhur. Më merr në telefon kur të mbarosh këtu, - i thashë thatë, duke i lënë të nënkuptonte se po largohesha.

- Më jep edhe pesë minuta. Po i përshëndes të gjithë dhe ikim.

- Jo, tani duhet vërtet të iki, - ia ktheva e vendosur.

Na ishte afruar një i ri, që po e shikonte Xhoin me ngulm, në pritje që të ndërhynte. Mbante veshur një palë xhinse dhe një bluzë, ndryshe nga gjithë të tjerët që ishin me xhakëtë e kollare.

- Jam Gabriel Lëfevrë, gazetar i *Liberation*-it. Ndjesë që po ju shqetësoj, por po vdes nga dëshira për t'ju bërë një pyetje, të cilën nuk munda ta bëja pak më parë para të gjithëve.

- Sigurisht, më thuaj.

- E kam lexuar tashmë romanin tuaj. Madje i kam lexuar të gjitha romanet tuaja. Ju jeni shkrimtari im i parapëlqyer.

- Faleminderit!

- Ky i fundit më pëlqeu më shumë nga të tjerët. Duket sikur është pothuaj një histori e vërtetë. Jam shumë kureshtar të di sesi do të përfundojë. Ju e keni lënë historinë pezull, pa një fund të vërtetë. E kam lexuar kapitullin e fundit nga dhjetë herë, por nga disa fraza mund të deduktoj se do të bashkohen prapë, ndërsa nga disa të tjera saktësisht e kundërta.

- Kësaj pyetjeje fatkeqësisht nuk di t'i përgjigjem. As unë nuk e di akoma fundin.

Vura re vështrimin ngurues të Lëfevrit, ndërkohë që edhe unë pyesja me vete mbi domethënien e asaj përgjigjeje.

- Mendoj se duke ua lënë finalen të hapur lexuesve, secili prej tyre do të gjejë të vetën, - vazhdoi Xhoi pas një pauze të shkurtër. - Dikush do të thotë që familja vjen e para dhe nuk mund ta braktisë gruan. Dikush tjetër mund të thotë që dashuria vjen para gjithçkaje. Secili do të zgjedhë finalen e tij në bazë të jetës së vet. Apo, ashtu siç ia ka mbrujtur jeta mendimet e tij...

- Nuk kuptova shumë nga përgjigjia juaj, por do të reflektoj mbi të.

- Nëse mund t'ju ngushëlloj, unë kam vite që reflektoj dhe akoma nuk kam kuptuar gjë, - komentoi Xhoi, me një buzëqeshje mes ironikut dhe misteriozit. Pastaj u kthye nga unë duke vendosur një dorë mbi shpinën time. - Po përshëndes fluturimthi nja dy persona dhe pastaj ikim.

- Shiko, nuk kam nevojë të më shoqërosh, - i thashë me një buzëqeshje të sforcurar. - Stacioni i metrosë është këtu ngjitur. Mbaro me qetësi gjërat e tua dhe çlodhu me gruan tënde. Është një mbrëmje e mrekullueshme dhe Parisi në këtë orë është shumë romantik.

- Gruan time? - pyeti duke zgurdulluar sytë.

- Emilia...

- Emilia? Je çmendur? Emilia është drejtoresha e shtëpisë botuese. Ajo e ka organizuar të gjithë këtë. Por, nuk është gruaja ime, sigurisht - u përgjigj i kënaqur. - Është gruaja e një miku tim të ngushtë, Bllejk Miler, ministri aktual i Kulturës. U detyrohem shumë Emilisë dhe Bllejkut. Nuk mjafton të shkruash një roman. Duhet të gjesh dikë që këtë roman ta kthejë në të rëndësishëm.

- Mendova se ishte gruaja jote.

Xhoi vazhdoi i pashqetësuar në mendimet e tij.

- Kështu është edhe në dashuri. Nuk mjafton të duash. Duhet të gjesh dikë që këtë dashuri dëshiron ta bëjë të rëndësishme...

Kapitulli 8

Katër litra purgativ

Rimboja u ofrua për të na shoqëruar në qendër me makinën e tij. Gjatë gjithë rrugës folën për një intervistë që duhej të dilte në ditët në vijim në gazetën *Le Monde*. Unë isha ulur në ndenjësën prapa dhe vështroja rrugën nga dritarja e vogël. Ishte një mbrëmje e mrekullueshme shtatori dhe Parisi, në atë orë, kishte një bukuri që të linte pa frymë. Na la në “Place Vendôme”.

- Këto ditë fle këtu, - tha Xhoi duke bërë me shenjë nga pallati përballë nesh.

- Në “Ritz”? - pyeta duke zgurdulluar sytë.

- Kështu mendoj Emilia. Që nuk është gruaja ime, - komentoi me ironi.

- Do të thosha se nuk të trajton keq. Nuk e ke më shtëpinë në “Rue du Temple”?

- Po, e kam, por Emilia ka organizuar këtu një sërë takimesh. Ulemi të pimë diçka? - pyeti duke treguar barin që ishte përballë nesh.

- Po, mirë.

U ulëm në tavolinën e vetme të lirë, që ishte jashtë.

- Në këtë çast kam ndjesinë sikur kemi qenë këtu dje apo pardje. Por, në fakt, ka kaluar një kohë e gjatë që atëherë, - tha Xhoi.

- Pothuaj dhjetë vjet. - Edhe unë ndieja kujtimet që po dilnin në sipërfaqe dhe që nuk arrija t’i ndaloja.

- Tetë vjet e shtatë muaj, - më korrigjoi Xhoi.

- Harrova që ke mbajtur llogarinë, - thashë duke qeshur.

- Kur presim dikë, vërtet të rëndësishëm, vazhdojmë të shikojmë orën, sepse mezi presim çastin që të mbërrijë, - komentoi Xhoi.

- Kur një person është vërtet i rëndësishëm, atëherë koha e humbet domethënien e saj. - U pendova menjëherë për atë çka thashë dhe u mundova ta drejtoja bisedën në një terren më të sigurt. - Të kam rezervuar një kolonoskopi për nesër pasdite.

- Një kolonoskopi?

- Po, kolonoskopi. I ke thënë Rënesë që nuk e ke bërë asnjëherë, apo jo?

- Jo, asnjëherë.

- Me ato vlera të hemoglobinës, duhet ta bësh patjetër. Duhet të bësh edhe një TAC pasnesër. T'i kam shkruar këtu të gjitha indikacionet. Orarin kur duhet të paraqitesh, etj. etj. - I zgjata fletën që e kisha nxjerrë nga çanta.

- Po ti nuk do të jesh në spital? - pyeti i shqetësuar.

- Do të jem, por nuk e di se në çfarë ore mbaroj në sallën e operacionit. Në rast se nuk arrij dot menjëherë, duhet vetëm të paraqitesh te recepsioni dhe pastaj gjithçka është e organizuar. Unë do të vij menjëherë sapo të lirohem.

- Mund të ma shpjegosh pse duhen bërë gjithë këto ekzaminime?

- Një nga shkaqet kryesore të anemisë janë polipet në zorrën e trashë.

- Polipe apo kancer? Dua të di gjithçka, - tha i alarmuar.

- Gjithçka, çfarë? Për momentin nuk dimë asgjë. Megjithatë, nëse shkak i anemisë është një polip, mikesha ime Natali Mersier do të ta heqë gjatë endoskopisë. Dhe çështja do të zgjidhet.

- Ke dhembje kur bën endoskopinë?

- Nuk ke për të ndier asgjë, frikacak. Do të jesh nën efektin e qetësuesve.

- Domethënë?

- Gjatë ekzaminimit do të jesh në gjumë. Harrova të të pyes nëse merr ndonjë ilaç. Aspirinë, antikoagulues....

- Jo asgjë. Jam i shëndetshëm si kokërr mollë, - u përgjigj i sigurt. - Eh, deri dje besoja se isha, - shtoi duke qeshur.

- Ah, mirë. Përndryshe do të duhej ta shtynim. Disa ilaçe duhen të ndërpriten disa ditë para ekzaminimit për të shmangur gjakderdhjen në rast se lind nevoja për të bërë biopsi apo të heqësh një polip.

- E urrej, më terrorizon fakti që duhet të flas për biopsi, heqje e gjakderdhje. Para ditës së djeshme nuk kisha hyrë kurrë në një spital. Dhe do të kisha parapëlqyer të mos ta futja këmbën as kësaj here. Por nëse ky është çmimi që duhet të paguaj për të të parë ty... eh, do ta paguaj me kënaqësi, - tha duke më parë në sy.

- Të gjithë do të donin të mos hynin në spital, por ndodh nganjëherë, - komentova duke u shtirë sikur nuk e dëgjova fjalinë e tij të fundit. - Ah, desh harrova gjënë më të rëndësishme. Para ekzaminimit duhet të bësh parapërgatitjen intestinale.

- Parapërgatitje intestinale? Ma shpjego mirë ç'duhet të bëj. Për disa gjëra nuk ia kam idenë fare.

- Janë katër qese me purgativ, - thashë ndërkohë që i zgjata një qese plastike, të cilën e nxora nga çanta. - Sapo të mbërrish në shtëpi, hidhe secilën qese në një litër ujë dhe pastaj duhet t'i pish.

- Katër litra? Si t'i pi katër litra ujë? Dhe pastaj, e marr me mend se duhet të kenë një shije të shpifur.

- Njëfarë shije e kanë, por duhet t'i pish. Do të shikosh që do të të bëjnë efekt... Kështu, koloni yt do të jetë i pastër nesër, dhe mikesha ime do ta studiojë si duhet.

- Gjithsesi, ke zgjedhur një profesion jo shumë poetik.

- Mua më pëlqen. Pastaj, nuk i pi unë ato katër litra...

- Nuk e kam njohur ende anën tënde sadiste.

- Njerëzit nuk njihen kurrë sa duhet... - u përgjigja me ironi.

- E saktë... Vazhdon të jesh e martuar me Marselin? Yt bir duhet të jetë rritur tashmë.

- Po, fatkeqësisht po rritet. Është bërë një djalosh tani.

- Përse nuk deshe të më takoje më? Përse nuk më përgjigjeshe më? Çfarë kuptimi kishte të ndaheshim në atë mënyrë absurde? Përse? - pyeti duke më parë me ngulm në sy.

- Nuk mund të bëja ndryshe. Dhe arsyen ti e di. Gjithsesi, nuk jemi këtu për të folur për të kaluarën. E kaluara është e kaluar, nuk ekziston më. Kanë kaluar shumë vjet prej atëherë. Më trego më mirë diçka për veten tënde.

- S'kam ndonjë gjë të madhe për të treguar. Kam pasur dikë që bashkëjetoja, por ka marrë fund disa kohë më parë. Do të jem ende i lirë, nëse, rastësisht, ndryshon mendje.

- Të pyeta për... - vura gishtin tregues mbi buzë, për të mos folur.

- Ndjesë, ke të drejtë. Nuk kam fëmijë, edhe pse më vjen keq për këtë. Fëmijët janë vazhdimi i jetës sonë. Iluzioni i pavdekshmërisë sonë. Por është më mirë të mos kesh, nëse e di që në fillim që nuk do të kesh kohë për ta. Unë ndihem mirë vetëm kur shkruaj.

- E di.

- Me ty do të kishte qenë ndryshe.

- Është e vështirë të thuash sesi do të kishin qenë gjërat që nuk i ke jetuar. Jepi, më trego për bashkëjetuesen tënde.

- Ish-bashkëjetuese. Nuk jemi më bashkë, por jemi miq. Është shumë ndryshe nga ti.

- E ke kuptuar më në fund që nuk isha tipi yt?

- Sigurisht që je.

Përse nuk e përmbajta veten dhe të mos e kisha bërë atë pyetje budallaqe? Nëse historia jonë kishte marrë fund prej shumë vjetësh, përse kisha ende nevojë të dëgjoja që isha e rëndësishme? Më e rëndësishmja. Sepse ishte kjo, në fund të fundit, që doja të

dëgjoja nga Xhoi. Ishte xheloz i ajo çka ndjeva kur e pashë të fliste me Emilinë. Ishte xheloz, edhe pse nuk doja ta pranoja. Kisha ende nevojë të shënoja territorin tim, si bëjnë qentë duke urinuar pas murit.

- Jepi tani, mbaro së treguari, - e nxita në mënyrë të beftë për të fshehur kënaqësinë që kisha ndier nga përgjigja e tij.

- Është një grua e thjeshtë. Ka një dyqan veshjesh. Shumë mikështa. Shkon në palestër. Është një nga ata persona që kërkojnë një jetë normale. Që gjejnë kënaqësi të një jetë normale.

Bëri një pauzë të shkurtër duke pritur që unë të bëja ndonjë koment. Pastaj nisi sërish të fliste.

- Kur e takova, mendova se ndoshta do të arrija të jetoja si gjithë të tjerët... Qëndruam bashkë një dy vjet dhe në njëfarë pike fillova të ndihesha i asfiksuar. Kam nevojë për hapësirat e mia, hapësira që ajo donte t'i pushtonte. Kam nevojë për liri, për vetmi. Dhe këtë, ajo nuk mund ta toleronte. Donte darka me miqtë, fundjava jashtë, të gjitha gjërat që unë nuk mund t'ia jepja. Më dukej sikur harxhoja kot kohën time.

- E kam ditur gjithmonë që kështu je gatuar.

- Ndoshta do të kisha pasur nevojë për dikë që të më shpëtonte nga vetmia ime. Por kush mund të na shpëtojë nga vetja jonë? Ndoshta dashuria. Sikur të kishim qenë bashkë...

- Besoj se çdokush duhet ta shpëtojë vetë veten. Është shumë e vështirë të gjesh një kompromis midis nevojës sonë për të qenë vetëm dhe nevojës sonë për afeksion. Ndoshta në momentet kur unë do të kisha nevojë për afeksion, ti mund të kishe nevojë për vetmi. Dhe kur unë të kisha nevojë për vetmi, ti do të kishe nevojë për afeksion. Marrëdhëniet janë gjithmonë të komplikuar. Dhe dashuria i bën akoma më të komplikuar.

- Ndërlikimet dalin në shesh kur nuk dashurohet mjaftueshëm...

- Jemi këtu për të shkëmbyer dy fjalë si miq. Dy miq të vjetër dhe kaq, - u përgjigja me një ton që nuk pranonte diskutime.

- Eh, jo vetëm miq të vjetër. Tani jam edhe pacienti yt... Dhe meqenëse ti më dhurove këto qeska të mrekullueshme me purgativ, kam edhe unë një dhuratë për ty. - Kishte rifituar tonin e tij të zakonshëm hokatar. Nxori nga çanta e shpinës një kopje të librit të tij dhe ma zgjati. Ballina ishte e kaltër me një fotografi bardhezi të një kafeneje... Ndjeva lotët të më ngjiteshin në sy, ndaj u detyrova të ulja shikimin.

- Të kujtohet? Në çdo roman ishe ti... Mes mijëra përngjasimesh, ishe gjithmonë ti...

- Mjaft, tani. E kaluara është e kaluar, - u përgjigja thatë. - Nuk arrij ta besoj që jam këtu në bar me shkrimtarin e famshëm Zhan-Lui Moro. Duhet të bëjmë një foto, që ta vendos në *Facebook* dhe t'i bëj të gjithë kolegët e mi të vdesin nga zilia.

- Shiko, jam unë ai që po vdes nga zilia. Ndërkohë që ti i kaloje ditët e tua duke u munduar të shpëtoje jetë njerëzish, unë i kaloja para kompjuterit duke kërkuar të shpëtoja fjalë.

- Mos thuaj budallallëqe...

- Nuk jam aq i sigurt nëse kam bërë zgjedhjen e duhur. Të shkruash romane është paksa si të heqësh dorë nga jeta bashkë me të tjerët, për të jetuar i vetëm në imagjinatë.

- Por, siç e the edhe ti pak më parë, kush shkruan kërkon të krijojë histori, ku të tjerët mund të gjejnë veten e tyre.

- Nganjëherë në mbrëmje, para se të fle, rilexoj disa faqe nga librat e tu dhe... më pëlqen të gjej aty, mes mendimeve të tua, një mendim timin. Kjo më bën të ndihem më pak e vetmuar.

U pendova menjëherë për atë çka thashë. Po fundosësja dhe nuk mund t'ia lejoja vetes. Duhej të gjeja një justifikim dhe të largohesha. Menjëherë. Nuk duhej ta kisha pranuar këtë takim, kurrë. Gjithçka ishte mjaft e gjallë brenda meje. Një plagë e hapur dhe e pambyllur kurrë. Gjatë viteve kishte zënë cipë, por ishte një cipë tejet e hollë. Tejet delikate. Kishte mjaftuar një vështrim i Xhoit që ajo të rihapej sërish. E dija që tashmë do të gjakosej...

- Ndjesë, por tani duhet të kthehem në spital, - thashë duke u ngritur në këmbë.

- Tani që sapo u ulëm?

- Kam një pacient që nuk është mirë. U thashë t'i bënin një TAC, por tani duhet të shkoj ta shikoj. - U sforcova të dukesh sa më e singertë.

- Nuk ma the më parë.

- Ishim duke folur dhe më doli nga mendja.

U ktheva menjëherë në shtëpi. Marseli më kishte lajmëruar që do të vonohej pasi kishte një mbledhje. U gëzova që nuk do të ishte në shtëpi. Kisha nevojë të qëndroja vetëm. U shtriva mbi shtrat për të lexuar romanin e Xhoit. E lexova të gjithin me një frymë, madje as nuk hëngra gjë. Ishte një histori dashurie. Një histori që ngjante me tonën. Ishte hera e parë, megjithatë, që më shkoj ndër mend se në romanet e Xhoit kishte gjithmonë një grua tjetër. Një personazh dytësor, ekzistencën e të cilit e kisha injoruar deri atë ditë. Një nga ato personazhet dytësore që, më pas, po të mendohesh mirë, janë më të rëndësishme sesa protagonistët. Sepse, ndërsa unë pushtoja ëndrrat e Xhoit, ajo ndërkohë pushtonte ditët e tij...

Atë mbrëmje, Marseli u kthye shumë vonë në shtëpi.

- Po fle? - më pyeti nën zë ndërkohë që shtrihej pranë meje. Qëndrova pa lëvizur dhe bëra sikur po flija.

Kapitulli 9

Mjellma e zezë

Normalisht, sapo mbaroj një ndërhyrje kirurgjikale, gjëja e parë që bëj është të kontrolloj thirrjet në celular. Janë gjithmonë aq shumë, sa nganjëherë më vjen t'i shuaj të gjitha, madje pa i parë fare. Por pastaj më pushton ndjenja e fajit dhe, atëherë, i lexoj. Dhe mbasi i lexoj, më mbërthen ndjenja e përgjegjësisë, për të cilën jam tejet e aftë, meqenëse jam e shenjës së Bricjapit. Kështu që iu përgjigjem të gjithave thirrjeve pa shmangur as edhe një të vetme. Edhe atë ditë kisha plot nëntëmbëdhjetë të tilla dhe pesë prej tyre ishin nga mikesha ime Natali Mersier. E mora menjëherë në telefon, madje pa e lexuar fare mesazhin që më kishte dërguar, duke qenë se e dija mirë për çfarë donte të më fliste.

- Të mora për të të pyetur nëse dëshiroje të ishe e pranishme në kolonoskopinë e mikut tënd.

- Do të kisha ardhur me kënaqësi, por isha në operacion. Si shkoi?

- Kam lajme të këqija.

- Domethënë?

- Ka një polip të madh të leshtë menjëherë pas valvulës *ileo-ciecale*⁶. Ka plotësisht pamjen e një tumori. - Mendova se nuk mund të ishte e vërtetë. Ndoshta ishte një ëndërr... Gëlltita pështymën dhe qëndrova në heshtje duke pritur që Natalia të vazhdonte.

⁶ Valvula që ndan zorrën e hollë nga koloni. Zona ngjitur me apendiksin, e cila kur inflamohet shkakton apendicitin (shën. i përkth.)

- Atij i thashë vetëm që kisha gjetur një polip dhe që do të bëjmë biopsinë. Dhe që do ta njoftojmë sapo të kemi rezultatin e saj. Gjithsesi, nuk kam dyshim që bëhet fjalë për kancer.

Nuk arrita t'i përgjigjesha menjëherë. Zëri më ishte zënë në grykë dhe nuk mund të flisja. Dyshoja që në fillim, por shpresova deri në fund që të kisha gabuar. Shpesh, kur jemi shumë të lidhur me një person, frika na çon t'i shikojmë gjërat më të zymta se ç'janë.

- Dyshova edhe unë sapo e pashë, - u përgjigja me zë të mbytur. - Anemi, asteni... Diagnoza ishte mjaft e lehtë.

- Më vjen keq. E di që e ke shumë për zemër.

- Po, kemi qenë shokë në lice. Është akoma aty?

- Jo, iku para gjysmë ore. Ia bëra nën efektin e qetësuesve, pastaj e mbajta edhe pak këtu në sallën e vogël. Sapo u zgjua pyeti për ty, por duke qenë se nuk përgjigjeshe në telefon, i thashë që me siguri ishte e zënë në sallën e operacionit dhe se ishte e kotë që të priste.

- Bëre mirë. Po e marr më vonë në telefon.

- Di që është një shkrimtar mjaft i njohur, - vazhdoi menjëherë Natalia. - Më kujtohet që të pëlqejnë shumë librat e tij. Dhe nuk je e vetmja. Të jem e sinqertë, mua nuk më bëjnë të çmendem. Romanet e tij janë shumë ekzistenciale, shumë filozofike... Të rënda.

Nuk isha e sigurt nëse ishte ky momenti i duhur për biseda letrare. Natalia ishte një endoskopiste e mirë. Më e mira. Por nuk kisha dyshim mbi faktin që asaj mund t'i pëlqenin romanet e Xhoit. Vërtet shumë të rënda për të.

- Librat e tij janë të thellë dhe e kuptoj që nuk mund t'u pëlqejnë të gjithëve. Por le të kthehemi... - Doja të ktheheshim menjëherë te Xhoi pacient, por Natalia më ndërpreu, duke shkuar më tej, e patundur me gjykimet e saj letrare.

- Për mua romanet e tij nuk janë të thella. Janë shumë të thella!

Me një fjalë, janë një mërzi e madhe. Sipas meje, i pëlqen paksa si shumë të kënaqet me thellësinë e vet. Është pak si shumë narcisit për shijet e mia. Unë jam njeri praktik dhe nuk i duroj stërholllimet mendore alla Prust. Parapëlqej një libër policor të bukur me një histori që duhet zbuluar.

- Ndërsa unë nuk i duroj dot librat policorë. Kuptohet që janë të gjitha histori të sajura. Gjithsesi, dëgjo, ta lëmë mënjane Zhan-Lui Moronë shkrimtar dhe të kthehemi te pacienti. Kujt ia dërgove analizën histologjike?

- Martin. E mora edhe në telefon madje, i shpjegova se cili është pacienti dhe i thashë edhe që është një miku yt. Do të na njoftojë sapo të ketë rezultatin. Megjithatë, nuk kam asnjë dyshim lidhur me diagnozën. Edhe pa ngjyrimin histologjik...

- Do të parapëlqejja të kishe dyshime. Ndërkohë që presim përgjigjen histologjike, do t'i bëj një TAC për të parë në çfarë stadi është tumori. Por, fillimisht, duhet të flas me të se çfarë do të bëjë. Jeton në Nju-Jork dhe ndoshta dëshiron të operohet atje.

- Nuk besoj. Nuk e kam kuptuar ende se çfarë u bën ti pacientëve të tu. Të gjithë janë të dashuruar pas teje. Magjia e kirurges. Askush nuk do të dashurohej me një endoskopiste.

- Mos thuaj budallallëqe.

- Eh, mirë. Më njofto se si do të përfundojë puna...

Eh, po, si do të përfundojë. Kush e di... Tani duhej t'i telefonoja Xhoit dhe t'ia thosha. Por si t'ia thosha një gjë të tillë? Përse fati më vuri përpara një detyrë kaq absurde? Përse pikërisht mua? Nuk mund t'i telefonoja menjëherë. Duhej të arsyetoja me mendje të ftohtë. Fillimisht të gjeja fjalët e duhura për t'ia thënë...

U përpoqa të rifilloja ditën e punës aty ku e kisha lënë. U nisa drejt repartit të terapisë intensive për të parë pacientin që kisha operuar një natë më parë. Më merreshin mendtë.

Klod Delanua ishte zgjuar dhe dukej në formë mjaft të mirë.

Madje, sikur nuk ishte bërë fare operacion. Sikur nuk i kishte ndodhur asgjë. Në fund të fundit, ishte i ri, dhe të rinjtë kanë shumë jetë brenda tyre. Ishte djalë i bukur. Flokë kaçurrelë dhe të zinj. Syjeshil. Trup atleti, nga ata që shkojnë në palestër dhe duken sikur po pëlcastin nga shëndeti.

- Jam kirurgia që ju operoi mbrëmë. Nuk arritëm të prezantoheshim, por ndërkohë i lejova vetes të njihesha me abdomenin tuaj. Një njohje mjaft e thellë...

- Ah, jeni ju? Nuk e di si t'ju falënderoj. Më thanë që isha katandisur keq. Me një fjalë, isha shumë në rrezik...

- Eh, po...

Ula mbulesën për t'i kontrolluar barkun. Nuk kishte gjak as te drenazhimi, as te qeska e sondës hundo-gastrike. Diureza ishte e mirë.

- Gjithçka po shkon mjaft mirë.

- Nuk mund të ma hiqni këtë tub të mallkuar nga hunda?

- Jo ende, duhet të bëni pak durim.

- Nuk e di nëse jua kanë thënë, por do të më transferojnë me ambulancë, sa më shpejt të jetë e mundur, në Reims. Xhaxhai im është shefi i kirurgjisë. Unë dhe gruaja ime ishim me pushime këtu.

- E di, xhaxhai juaj më mori në telefon. Për mua nuk ka asnjë problem. Mund të transferoheni që nesër nëse gjithçka shkon mirë. Për më tepër, Reimsi është pak më shumë se një orë prej këtej.

- Më thanë se, për të ndaluar hemorragjinë, më hoqët një pjesë të stomakut.

- Po, ashtu është.

- Domethënë tani është gjithçka në rregull? Nuk ka më rrezik për hemorragji, apo jo?

- Jo, kjo jo. Duhet të presim rezultatin e ekzaminimit histologjik.

- Pse nuk ishte një ulcerë? - pyeti i alarmuar.
- Gjithmonë bëhet ekzaminimi histologjik i pjesëve të operuara për të qenë të sigurt që nuk do të ketë më probleme...
- Të shpresojmë që të mos ketë. Këto pushime në Paris do t'i kujtojmë si makth.

Ndërkohë që po sistemoja batanijen, të cilën e kisha ulur për t'i ekzaminuar barkun, vura re një tatuazh në gjoksin e tij. Ishte shkruar *Remembering Clare*. Nuk i rezistova dot kureshtjes për të mësuar më shumë.

- Kush është Klera?
- Ka qenë mamaja ime. Fatmirësisht ishte ajo që më ndihmoi mbrëmë.
- Eh, po. Fatmirësisht që ishte ajo...

Kapitulli 10

Pinoku

Dhe tani duhej ta merrja Xhoin në telefon dhe t'ia thosha. Duhej ta merrja në telefon dhe t'i thosha të vërtetën ose të paktën një pjesë të së vërtetës. E dija tashmë se si do ta filloja. “Më vjen keq, por kam diçka për të të thënë...” Dhe fill pas kësaj do të shtoja: “Gjithsesi, duhet të jesh i qetë, do të shikosh që nuk është asgjë... Gjithçka do të shkojë mirë”. Por, si drejtin them që gjithçka do të shkojë mirë? Askush nuk e di, madje as unë. Atëherë, përse ta them? Apo sepse ky është refreni i kirurgut, një refren që më është dashur ta përsëris me mijëra herë dhe tani e di përmendësh. Të thuash dhe ndërkohë të mos thuash. Të shpjegosh, pa shpjeguar. Njerëzit mësohen me të gjitha, ose të paktën mundohen të mësohen me të gjitha. Edhe nëse kanë një tumor në trupin e tyre. Por kanë nevojë për kohë dhe, nganjëherë, edhe për ndonjë gënjeshtër.

Ndërkohë që mendohesha se çfarë duhej ose jo t'i thosha Xhoit, më mori në telefon Lorani, drejtori. Isha e kënaqur për këtë telefonatë, së cilës nuk do t'i isha përgjigjur, nëse nuk do të më shërbente, atë moment, si justifikim për të shtyrë telefonatën me Xhoin.

- Ah, më në fund. Mund të ma shpjegosh përse nuk përgjigjesh kurrë në celular?

- Ti e di që celulari nuk kap në sallën e operacionit.

- Mos më trego broçkulla mua. E di shumë mirë që nuk je ditë e natë në sallën e operacionit. Të kam marrë në telefon të paktën dhjetë herë këto dy ditët e fundit.

- Ndjesë! Më kanë shpëtuar.

- Dhjetë telefonata të kanë shpëtuar? Pak e vështirë për t'u besuar. Më bën për budalla.

- Nuk do t'ia lejoja kurrë vetes këtë.

- Mirë. Gjithsesi, duke qenë se arrita më në fund të të gjej, po dal drejt e në temë. Doja të flisja lidhur me zgjedhjet për rektorin.

Tema e telefonatave të Loranit ishte gjithmonë e njëjta: pushteti. Në atë kohë Lorani ishte drejtor i Njësisë Operative të Kirurgjisë së Përgjithshme në spitalin *Sacré Coeur*, si dhe drejtor i Departamentit të Kirurgjisë, edhe pse, në fakt, nuk kishte qenë kurrë kirurg. Kirurgjia nuk i kishte interesuar kurrë. I interesonte vetëm pushteti dhe vetëm ai. Por, edhe pse ishte pothuajse në majë të gjithçkaje, nuk mjaftohej kurrë. I kalonte ditët e tij duke menduar sesi të fitonte pushtet, si ta ruante, si të kishte gjithnjë e më shumë pushtet. E pyesja shpesh veten se ku do të arrinte dhe, duke marrë parasysh impenjimin me të cilin u përkushtohej objektivave të tij, nuk kam pasur kurrë dyshime që e priste një karrierë e shkëlqyer. Një karrierë e ndryshme nga imja, por secili prej nesh ka shijet e veta dhe e rëndësishme në jetë është të bësh atë çka të pëlqen.

- Ka ndonjë të re? - pyeta duke u sforcur të dukesh kureshtare, edhe pse e dija që nuk do të më besonte. Lorani më njihte mirë, ashtu siç e njihja edhe unë atë. Punonim bashkë që prej shumë kohësh, nuk kishte mundësi të mos e njihnim njëri-tjetrin. Ai e dinte që mua nuk më interesonte aspak pushteti, ashtu siç e dija edhe unë që atij nuk i interesonte aspak kirurgjia. Por që të dy bënim sikur nuk kuptonim asgjë.

- Ne të mjekësisë mbështesim të gjithë Bonetin. Dhe doja të të ftoja që, edhe ti, të bësh të njëjtën gjë. E kemi mik. Një mik të shtrenjtë. Është dikush, të cilit mund t'i besojmë.

- Nuk e njoh.

- Nuk ka mundësi të mos e njohësh. Është drejtori i Kardiokirurgjisë.

- Po. Por nuk e njoh.

- Thelbi i çështjes është se duhet të bëhemi bashkë kundër atij të Jurisprudencës, njëfarë Perrin. Sipas meje nuk do ta votojnë as ata të Jurisprudencës, megjithatë është mirë të mos rrezikojmë.

- Po, sigurisht.

- Fola për ty me Bonetin. Do të donte t'i takonte të gjithë miqtë, para takimit zyrtar të premtën. Ka organizuar një darkë për nesër mbrëma, ku do të parashtrojë edhe programin e tij.

- Ndjesë nëse të ndërpres, por nesër në darkë kam një angazhim që nuk mund ta shmang. - Kisha arritur të sajoja fluturimthi një justifikim.

- Më vjen keq që nuk mund të vish. Jo për programin. Kujt i intereson programi. I kam folur për ty. I kam thënë se do të të interesonte të kishe drejtimin e një njësie operative të Kirurgjisë Onkologjike...

Bëri një pauzë të shkurtër, duke pritur që unë të ndërhyja, por nuk e hapa gojën. E njihja mirë Loranin. Në periudhën paraelektorale do të ishte i aftë të më premtonte edhe fronin e Francës ose papatin madje. Por për fat të keq vuante nga amnezia dhe, sapo arrinte atë që donte, i harronte shumë shpejt ato çka kishte premtuar.

- Jemi marrë vesh tashmë. Nëse arrijmë ta zgjedhim, Kirurgjia Onkologjike është jotja. Pra kujdes. Duhet të përkushtohesh.

- Po, sigurisht, - u përgjigja duke u sforcuar të isha sa më bindëse. E kisha kuptuar tashmë se ku donte të arrinte. Ishte loja e tij e zakonshme. T'i ofronte Bonetit një paketë të mirë votash dhe, nëse fitonte, të merrte në këmbim një post të mirë. Ndoshta edhe atë të zëvendësrektorit.

- Më vjen keq që nuk do të jesh në darkë, vazhdoi. - Do të bisedonim bashkë. Por nuk është dhe aq thelbësore. Ishte vetëm një rast për të të prezantuar me Bonetin. Gjithsesi, e rëndësishme është që të jemi të gjithë kompakt kundër Perrinit. Dhe do të shikosh që Boneti do të dijë të ta shpërblejë. Edhe unë gjithashtu.

Nuk u përgjigja. Qesha me vete ndërkohë që mendoja hundën e Loranit që zgjatej jashtë mase si ajo e Pinokut. Dhe vazhdova të qesh duke përfytyruar trupën kompakte të profesorëve të shquar, që vërsulej kundër Perrinit të shkretë.

- Do të të përditësoj mbi të rejat, - tha Lorani.

- Faleminderit! - u përgjigja duke mbyllur telefonatën.

Të gjitha mendimet e mia u kthyen papritur te Xhoi. Duhej t'ia thosha. Duhej të gjeja fjalët për t'ia thënë.